

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7728 E martë 4 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Ka një strategji ngjashmërisht të frikshme mes atyre që mbrojtën shembjen e teatrit dhe atyre që e kanë shndërruar në kauzë rrafshimin e shtëpive tek Unaza ...
Vijon në faqen 20

Nga ANDI BUSHATI
Ajo që mbështetësit e Ramës për Unazën nuk guxojnë ta thonë


Analiza *e* **Ditës**
Një projektligj i propozuar nga qeveria e kryeministrit Edi Rama synon të anulojë Aktet e Marrjes në Përdorim të Tokës Bujqësore në zonat bregdetare ...
Vijon në faqen 21

Nga GJERGJ EREBARA
Qeveria, shpronësime në bregdet për llogari të investitorëve "strategjikë"




"Rritja ekonomike 4-fish nga viti 2013"
Miratohet buxheti, Arben Ahmetaj: Në fundvit shpërblim për pensionistët

Ministri i Ekonomisë dhe Financave: Ky është buxheti më i madh në historinë e Shqipërisë
Ashtu si edhe çdo vit tjetër edhe për festat e këtij fundviti qeveria do të shpërndajë një bonus për të gjithë pensionistët. Masa e shpërblimit do jetë në masën e 5 mijë lekëve të reja dhe lajmin e dha vetë ministri i Financave, Arben Ahmetaj gjatë një konference për mediat të mbajtur mbrëmjen e djeshme. "5 mijë lekë të reja për ..."
Në faqet 4-5

INTERVISTA/ MINISTRI I DIASPORES: PERPLASJA PER TEATRIN, POR E KAM MIK MAJKO: RAMES I DOREZOVA DOREHEQJEN NE ZYREN E TIJ

Ish-kryeministri dhe deputeti i PS-së rrëfhet tek Adi Krasta në "News 24": Rama të mos kandidojë prapë Veliain? Do të dëmtonte veten, jo Erionin



(Në foto) Ministri i Diasporës, Pandeli Majko dhe kryeministri Edi Rama

LISTA E TRASHËGIMTARËVE
Kësti i tretë i dëmshpërblimit, emrat dhe dosjet e të përndjekurve
Në faqet 10-12

KRIMI NE KORFUZ
Fashisti grek i "Agimit të Artë" vrau shqiptarin dhe e hodhi në kanal
Në faqen 6

SHENDETESI
Zbardhen datat e regjistrimit për praktikën e farmacistëve
Në faqen 8


SIMPOZIU
"Qytetërimi osman", promovohet vepra që flet për shqiptarët në shekullin e 15-të
Në faqen 17

DOKUMENTI/ Gjeneral Majori "shfajësohet" në vitin '47 për vrasjen e 21-vjeçares: Jini kryelartë

Letra e Mehmet Shehut për familjen e Ramize Gjebresë

"Pushkatimi ishte i ekzagjeruar, por Balli bënte propagandë për moralin tonë"

Nga FATMIRA NIKOLLI
Gjykata e Lartë e Komandës së Përgjithshme, në këto kohë e fundit mori në rishqyrtim dënimin e dhënë vajzës t'uaj Ramize, n'operacionin e dimrit 1943-944 nga ana e Gjyqit të Brigadës V-të. Nga ky



rishqyrtim u konstatua se nga rrethanat në të cilat u dha dhe u ekzekutua vendimi mbi vajzën t'uaj Ramize kanë qenë të vështira për Lëvizjen t'onë N.Ç.L duke marrë parasysh propagandën që bënte okupatori dhe Balli Kombëtar kundrejt ...
Në faqet 18-19

UNAZA E MADHE PROTESTA

Kreu i PD-së thirrje shqiptarëve: Harroni ngjyrat, të bashkohemi kundër Rilindjes

Valentina Madani

Basha: Qytetarëve u shemben shtëpitë, qeveritarët shpenzime luksi

"40 milionë euro shpenzon qeveria tek Unaza e Re"

TAKIMI

Kreu i PD-së Lulzim Basha takoi dje kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhi dhe atë të PR-së, Fatmir Mediu. Mendohet se gjatë takimit është diskutuar çështja e mandateve të deputetëve dhe aksionet e asaj që quhet 'opozita e bashkuar'. Më herët, Fatmir Mediu dhe aleatë të tjerë kanë kërkuar publikisht që t'i jepet fund bojkotit parlamentar.



Kreu i opozitës Lulzim Basha

THIRRJA

"Do falimentoni ju dhe do mbani përgjegjësi. Hiqni dorë nga piramida e PPP. Asnjë nuk do tolerohet. Një për një koncesionet do anulohen dhe paratë do i kthehen qytetarëve. Mos u zhyni në këtë vjedhje se do mbani përgjegjësi. Duan të nxjerrin familjet nga shtëpia e tyre, pasi u janë errësuar sytë nga grabitja. Nuk është betejë për të majtën apo të djathtë, por bëhet fjalë për në grusht shushunjash që po grabisin shqiptarët" - tha z.Basha.



Protesta e djeshme e banorëve të Astirit



'Unaza', Patozi: PD të protestojë për korrupsionin galopant

Ish-deputeti demokrat Astir Patozi, foli dje për protestën që po zhvillohet tek Unaza e Re dhe qëndrimi i opozitës. "Nëse opozita zyrtare do që të protestojë për korrupsionin galopant dhe të gjithëpëhapur të qeverisë, ajo nuk ka pse qëndron tek Astiri, sepse aty vetëm ndonjë fadromë apo buldozer të kompanive private mund të gjejë. Aty e ka kryeministrin, le ta rrethojë dhe të qëndrojë atje deri në rrëzimin përfundimtar të Edi Ramës. Le t'i bashkohet asaj proteste madhështore edhe banorët fatkeq të Unazës së Re, sepse nuk e kanë shumë larg, por dhe qëllimin e arrijnë njësoj ashtu. Dhe me atë rast opozita nuk shpëton vetëm shtëpitë e tyre nga prishja, por çliron një popull të tërë nga një qeveri që po i merr shpirtin, duke e grabitur dhe poshtëruar", shprehet Patozi përmes një shënimi në 'Facebook'.

'Shkoza' zmbrraps IKMT-në, nis shembja e banesave

Bumçi e Duma krahu banorëve: U është premtuar legalizimi, u lind e drejta të...



letër e firmosur, por u janë dorëzuar vetëm disa letra bakalli dhe u janë bërë premtime që do u legalizohen shtëpitë. "Banorët kanë kërkuar të ndryshohet projekti, ka një ping pong pasi thonë që është projekti i Adil

Çarçanit. Por po të shikosh në vitin 2011 këto banesa nuk prekehshin, ishte një numër i vogël që do prisheshin. Jemi sot në situatën që prek më shumë se 300 banesa, dhe numri i saktë nuk dihet, sepse, siç e shikoni në 2016

kanë pasur një tjetër trajektore rruge dhe vitin pas ardhës trajektore tjetër. Banorëve u lind e drejta që të dëgjojnë thashethemet dhe të dyshojnë se këtu mund të ndërtohen pallate e qendra biznesi, që nuk mbetet te vepra publike. Një tjetër gjë është se nuk ka një tabelë informuese, pasi të jesh qytetar do të thotë të jesh i informuar se kush është shkelur ligjit. Ne e dimë që Shqipëria ka probleme me pronat kudo, këto janë gjëra që nuk e dimë. Janë mbajtur nën presion se u kanë thënë do ua legalizojmë, u kanë dhënë letra pa firmosur", tha znj.Duma.

të qëndrojnë në pushtet sepse na ka ndarë fije-fije. Ku secili shikon hallin e vet, indiferent për hallin e vet, le të bashkohemi të gjithë së bashku dhe ta kthejmë këtë buxhet në epifanin e merituar dhe gurin e varrit për organizatën kriminale të "Ril-

indjes". Mos ta lejojmë të shkojë asnjë ditë më tutje, grabitja e taksave tuaja, vjedhja e të ardhmes së fëmijëve tuaja. Shikoni fëmijët tuaj në sy! Në qoftë se ju ka mbaruar pak fuqi dhe jeni drobitur, do bësitur e lodhur nga hallet që ju janë ngar-

kuar mbi shpinë, shikoni në sy fëmijët tuaj, vogëlushë apo të rinj! Luftoni për ta, luftoni për të ardhmen e tyre. Ata nuk dorëzohen dhe nuk do të dorëzohen dhe opozitën do ta keni në krah hap pas hapi", theksoi kreu i PD.

Kreu i opozitës Lulzim Basha akuzoi dje qeverinë e kryeministrit Edi Rama se po pasurohet duke vjedhur pasuritë e shqiptarëve. Shembulli më tipik i vjedhjes së shqiptarëve, sipas Bashës, është projekti i Unazës së Madhe: "Paratë e shqiptarëve, rrush e kumbulla. 40 milionë euro shpenzon qeveria tek Unaza e Re, të njëjtën shumë ka ndarë për një vit për ndihmë ekonomike". "Vetëm në projektin korrupsiv të Unazës së Re do të hidhet një shumë e barabartë që shteti parashikon të harxhojë gjatë një viti për familjet në nevojë ekonomike. Kemi mbi 150 mijë familje në nevojë ekstreme që nuk sigurojnë dot bukën e gojës. Buxheti për këta njerëz është i barabartë me vjedhjen e Unazës së Re", theksoi z.Basha. Përballë një situatë të tillë kreu i PD-së kërkoj bashkimin e të gjithë shqiptarëve, të majtë e të djathtë kundër Rilindjes. Kreu i PD u ka bërë thirrje qytetarëve të harrojnë ngjyrat dhe të ngrihen kundër maxhorancës që sipas tij po vjedh shqiptarët. Madje Basha kërkoj ta kthejmë buxhetin e 2019, në epitaftin dhe gurin e varrit për Rilindjen. "Pa dyshim që çdo shoqëri e emancipuar e kupton fare mirë zgjidhjen përpara se cilës ndodhet. Dhe unë ju kërkoj sot, t'i harrojnë ngjyrat. Mos i shikoni ngjyrat. Pa dyshim vij dhe flas këtu si kryetar i Partisë Demokratike, kemi një alternativë të qartë, për t'i rikthyer paratë në xhepat tuaj. Por kjo nuk është më një betejë midis së majtës dhe së djathtës. Kjo është një betejë për ekzistencën apo jo të këtij vendi dhe këtij populli, kundër një grushti shushunjash që tani po përgatitet të vjedhë gjithçka edhe me ligj, siç është ligji i buxhetit dhe ta boshatisë vendin. Kjo është arsyeja përse ka regjimin më armiqësor ndaj shtresës së mesme, ndaj profesionistëve, ndaj mjekëve, ndaj inxhinierëve, ndaj avokatëve, ndaj ekonomistëve, i takson më mizorisht, se në çdo vend tjetër, në një arsye të vetme, që t'ju ulë kokën dhe t'ju mbyllë gojën. Kam një thirrje për përfaqësuesit e kësaj shtresë. Kuptojeni se kjo nuk është asgjë tjetër veçse një lojë banditeske, e Edi Ramës", deklaroi Basha. Ai tha se Rama i rrit taksat që t'ju mbyllë gojën qytetarëve e t'i përçajë. "Nuk ka nevojë të rrisë tak-

sat mbi ju. I rrit taksat mbi ju, që t'ju kontrollojë. T'ju mbyllë gojën, që të mos reagoni. T'ju ndajë, t'ju përçajë. Shtresa e mesme, intelektualët, profesionistët, janë ata që duhet të ngrihen të paratë. Së bashku me studentët. Edi Rama vazhdon



Protestuesit bllokjnë rrugën, Rama: Respekt për "jelekët e verdhë", por projekti vazhdon

Protestë si në Francë, "jelekët e verdhë" bëhen portokalli në "Astir"

"S'na ndalini dot, shtëpitë do t'i mbrojmë me gjak"

Valentina Madani

Banorët e "Astirit" protestuan mbrëmë ndryshe nga 29 ditët e mëparshme të protestës në mbrojtje të banesave të tyre. Të frymëzuar nga rezistenca e "jelekëve të verdhë" në Francë, banorët e "Astirit" në ditën e 30 të protestës së tyre zgjodhën të veshin edhe ata jelekë, por ngjyrë portokalli. Të veshur me jelekë fosforeshentë, duke marrë shembull nga protestat e organizuara në Francë kundër rritjes së çmimit të naftës, ata bllokuan pasditen e djeshme rrugën tek Unaza e Re, duke u shprehur kundër prishjes së banesave të tyre. Ata i bënë thirrje kryeministrit Edi Rama që të tërhiqet nga projekti që u prish banesat e tyre, ose t'i dëmshpërblejë qytetarët me 100 për qind të vlerës së tregut. Por, më herët kryeministri Edi Rama u shpreh i vendosur për të vijuar projektin e zgjerimit të Unazës së Madhe, pavarësisht protestave të banorëve prej një muaji. Në seancën e djeshme parlamentare, Rama iu referua si "jelekët e verdhë" protestuesve, një referencë kjo ndaj protestave të ditëve të fundit në Francë. "Me gjithë respektin për 'jelekët e verdhë', mendoj se jemi në rrugën e duhur me projektin", theksoi Rama. Gratë e Unazës së Re të kapura dorë për dorë i bënë apel kryeministrit Edi Rama që të heqë dorë nga vendimi i tij për të prishur shtëpitë dhe që t'i nxjerrë ata jashtë. Ato ishin të qarta me mesazhin e tyre nuk kanë për t'i dorëzuar pa u dëmshpërblyer më parë. Në mbështetje të protestuesve ishin edhe deputetët e opozitës. Deputeti i Partisë Demokratike, Klevis Balliu u bëri thirrje të gjithë shqiptarëve që t'u bashkohen së banorëve të Unazës së Re, Bulevardit të Ri dhe Shkozës, pasi armiku i përbashkët i të gjithëve është kryeministri Rama dhe korrupsioni. "Këta banorë këtu po luftojnë kundër korrupsionit të kësaj qeverie, pasi është korrupsioni që po i nxjerr këta nga shtëpia. Paratë e dëmshpërblimit të tyre i ka vjedhur Edi Rama. Shumë shpejt llogaritë 'off-shore' të Ramës do të gjenden.



SHEMBULLI

Të veshur me jelekë fosforeshent, duke marrë shembull nga protestat e organizuara në Francë kundër rritjes së çmimit të naftës, ata bllokuan pasditen e djeshme rrugën tek Unaza e Re, duke u shprehur kundër prishjes së banesave të tyre.

PROCESI



Unaza e RE, ARRSH: U krye vlerësimi për 10 objekte të tjera

Autoriteti Rrugor Shqiptar vazhdoi edhe dje procesin e vlerësimit të banesave në kuadër të projektit për rehabilitimin e Unazës së Madhe të Tiranës, segmenti nga Pallati me Shigjeta tek sheshi "Shqiponja". Inxhinierët e ARRSH ishin të pranishëm në objektet e depozituar dosjet pranë këtij institucioni dhe kanë kërkuar t'u nënshtrohen vlerësimeve dhe procesit të shpronësimit. "Sot (dje) u bë e mundur që në të tre lotet të kryhet verifikimi i 10 objekteve tjera kryesisht disakatëshe. Duke llogaritur edhe objektet e verifikuara më parë, ARRSH konstaton se janë vlerësuar 82% e totalit të atyre që deri më tani kanë dorëzuar dokumentet në ARRSH", thuhet në njoftim. Në ditët e ardhshme do të vazhdojë ky proces verifikimi për të gjithë banorët që depozitojnë dosjet.

Unaza e Re, deputetët e LSI letër Gjignurit, Qëndros e Lames

Deputetët e LSI për qarkun e Tiranës i dërguan dje një letër ministrit të Energjetikës, Damian Gjignurit, Afrim Qëndros, drejtor i përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe drejtorëve të tjerë që kanë vendimmarrje për ndërtimin e Unazës së Re. Deputetët e LSI, Endrit Brahimllari, Kejdi Mehmetaj, Floida Kërpaçi kanë rënditur disa pyetje, për të cilat kërkojnë përgjigje nga institucionet përkatëse. "Kush e ka hartuar projektin përfundimtar të zgjerimit të segmentit rrugor në zonën e 'Astirit' dhe gjithë pjesën e Unazës së Madhe të Tiranës? Kush e ka kërkuar hartimin e këtij projekti? A është miratuar projekti përfundimtar konform ligjeve të Republikës së Shqipërisë? Sa është vlera totale e projektit dhe a është bërë një studim fizibilitet? Ju lutem të na vendosni në dispozicion projektin të shoqëruar me të gjithë detajet teknike. A janë zhvilluar konsulta publike përpara miratimit të projektit përfundimtar nga institucionet shtetërore përgjegjëse? Sa është numri i pronave private që janë përlogaritur të shemben për të bërë të mundur realizimin e këtij projekti? Sa është sipërfaqja totale e këtyre pronave?", thuhet në letër.

Zgjatimi i Bulevardit të Ri, akuzat e opozitës

Tabaku, me banorët e Bregut të Lumit: Asnjë dëmshpërblim për shtëpitë e shembura

Banorët që ju shembën banesat nga ndërtimi i lotit të tretë të Bulevardit të Ri në Tiranë kërkojnë dëmshpërblim për pronat e tyre. Në mbështetje të këtyre banorëve ishte dje deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku. "PD mbështet protestën e drejtë të këtyre banorëve për disa arsye. E para, në dokumentet zyrtare të Bashkisë së Tiranës këtyre banorëve u ka dalë vlerësimi i pronës. Secili prej tyre ka dosje të tëra që kanë qenë në proces legalizimi. Një pjesë të tyre në i kemi përgatitur dhe VKM-të dhe kanë marrë shpërblimin. Ndërkohë që sot qeveria në panik po zbaton dy standarde. Njëerës palë i ka dhënë dëmshpërblimet ndërsa të tjerëve u thotë që për



Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku

pesë ditë do të largohen ose tek banesat sociale ose duke marrë bonusin e qerasë", tha Tabaku. Sipas saj, këta banorë nuk kanë marrë akoma dëmshpërblim për banesat e shembura për Bulevardin e Ri. "Kjo që po ndodh në Tiranë është e paprecedentë, kjo që po ndodh me trajtimin e pronës është e paprecedentë. Këta banorë du-

het të vlerësohen me të njëjtin standard që janë vlerësuar komshinjtë e tyre. Në dy lotet e para deri në 2013 në përgatitëm dy VKM ku të gjithë banorët u dëmshpërblen me një çmim që varioonte nga 23 mijë lekë deri në 26 mijë të reja për metër katror për banesën", tha deputetja e PD-së.

Rama duhet të japë llogari se ku kanë shkuar paratë e taksave që këta banorë kanë paguar për 25 vite. Prandaj të gjithë qytetarët shqiptarë duhet të bashkohen me këta banorë, pasi të gjithë jemi në luftë me korrupsionin. Shkroza u ngrit, bulevardi u ngrit, kështu duhet të bëjë çdo qytetar për të rrezuar emblenë e korrupsionit me emrin Edvin Kristaq Ramën. Kambanat për qeverinë

kanë kohë që kanë rënë", deklaroi Balliu. Edhe deputeti i LSI, Endrit Brahimllari, ishte sërish mbrëmë në krah të protestuesve tek Unaza e Re, të cilët kërkojnë dëmshpërblim të plotë për pronat e tyre. Në një prononcim për mediat, Brahimllari deklaroi se i gjithë ky projekt është abuziv dhe se kryeministri Rama nuk u shërben më qytetarëve, por krimin dhe oligarkëve.

"Kemi kërkuar informacion nga institucionet mbi projektin. Meqenëse qeveria heziton të sqarojë qytetarët, kemi kërkuar informacion zyrtar. Edi Rama është i fokusuar tek vjedhja dhe korrupsioni. Ky kryeministër nuk u shërben qytetarëve, por oligarkisë dhe krimin. Edi Rama është një kryeministër hajdut", deklaroi Brahimllari.

**KUVENDI
VOTIMI**

PS miratoi me 76 vota dhe pa opozitën ligjin buxhetor dhe paketën fiskale

Buxheti 2019, Rama: Paga më të larta dhe investime të reja

Përfitojnë 65 mijë nëpunës, rritja 7 deri në 20%

Mazhoranca votoi dje me 76 vota dhe pa praninë e opozitës, Buxhetin e Shtetit për vitin 2019 dhe paketën e ligjeve fiskale që e shoqëron atë. Buxheti kap një vlerë prej 458.2 miliardë lekë, ndërsa synon të ruajë ritmin e rritjes ekonomike, konsolidimin financiar dhe krijimin e 30 mijë vendeve të punës. Ndërkohë që do të sjellë një rritje të pagave në masën nga 7 deri në 20 përqind për afro 65 mijë të punësuar në sektorin e shëndetësisë, arsimit, ushtrisë dhe diplomacisë. Sa i përket paketës fiskale, ajo sjell risi uljen e barrës tatimore për grupe të caktuara individësh, si të punësuarit me nivel të mesëm pagash, uljen e barrës së kombinuar fiskale mbi fitimin dhe dividendin për kompanitë, dhënien e incentiveve dhe stimuljeve tatimore për industrinë dhe sektorin e caktuar si bujqësia, fasoneria, farmaceutika e të tjerë; stimulimin e politikave në transport, në funksion të mbrojtjes së ambientit dhe rregullime të barrës fiskale në fushën e mallrave të akcizës.

RAMA

Referuar pikërisht këtyre risive, kreu i qeverisë, Edi Rama duke folur dje në seancë plenare theksoi pikërisht faktin se buxheti dhe paketa fiskale e vitit të ardhshëm do të ruajë stabilitetin e rritjes ekonomike, si dhe do të financojë një sërë veprash të rëndësishme publike. "Unë jam shumë krenar që ne, sot kalojmë një buxhet dhe një paketë fiskale që vitin e ardhshëm do të na japë qëndrueshmëri të rritjes së mëtejshme ekonomike, do të na japë vepër në infrastrukturë në zhvillim të mëtejshëm, do të na japë impakte të rëndësishme në të gjitha kategoritë, që nga rritja e pagave deri te zerimi i taksës mbi inputet bujqësore dhe do të na japë mundësi të reja për buxhetin e vitit 2020", tha kryeministri Edi Rama.

PAGAT

Ndërkohë që duke iu referuar pikërisht pikave

më të nxehta të debatit të zhvilluar edhe në Komisionin e Ekonomisë, kryeministri Edi Rama hodhi poshtë mundësinë e përfshirjes në grupin e pagave të patat-

ueshme dhe rrogat deri në 40 mijë lekë. Ai bëri të ditur se mes kërkesës për ta ulur në 15 mijë lekë dhe asaj për të rritur në 40 mijë lekë fashën e pagave të patat-

ueshme, ai zgjidhte që të mbetej ajo që ishte, pra që pagat deri në 30 mijë lekë të mos tatonen. "Pagat 300 deri në 400 mijë lekë, është mirë ta kujtojmë, - taksoheshin 10%. Sot taksohen më pak se 2%. 1.89! 1.89 është një taksim, i cili është një kontribut në raport me ata që janë 300 e poshtë që nuk paguajnë asgjë. Pra, fillon progresiviteti dhe është gjëja më normale, prandaj unë kam qëndruar ashtu si shumica e grupit parlamentar dhe shumica e qeverisë, në pozicionin që as andej, as këtej. As me idenë që të zbrisim më poshtë tek 150 mijë lekëshi, sepse bie ndesh me një parimësi që e kemi vendosur që në fillim dhe as me idenë që të fillojmë dhe të zërojmë mbi 300 mijë lekëshin", theksoi kryeministri.

BUXHETI NË SHIFRA

- Të ardhurat buxhetore, 458.2 miliardë lekë.
- Shpenzimet buxhetore, 519.4 miliardë lekë.
- Rritje ekonomike, prej 4.3 përqind.
- Ulet borxhit publik në 64.9 për qind.
- Hapen mbi 30 mijë vendeve të reja të punës.
- Rënie e nivelit të papunësisë nën 12%.
- Ulet norma e tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%.
- Rritet kufiri i pagës që tatohet me 23% nga 130 mijë lekë, në 150 mijë lekë.
- Ulet masa e taksës me 2/3 për materialet plastike.
- Ulet me 50% edhe e masës së taksës për ambalazhet e qelqit.
- Rritet renta minerare për eksportin e kromit nga 6% në 9%.
- Hiqet taksë e karbonit për eksportin e natës.
- Përfshihen në import i lëndëve të para për fabrikat e prodhimit farmaceutik.
- Përfshihen nga TVSH-ja e furnizimit me shërbim në industrinë fason.
- Përfshihen nga TVSH-ja importi i makinerive bujqësore.
- Normë e reduktuar TVSH-je 10% për importin e autobusëve elektrikë të transportit publik.
- Normë e reduktuar 6% për shërbimin e reklamave nga televizionet.
- Akcizë 1 lekë/kilogram për zavorret bituminoze, që përdoren si lëndë djegëse alternative.
- Hiqet akciza për fshëkzjarrët, llambat, pilot/bateritë.
- Rritet akciza për duhanin e përpunuar dhe zëvendësohet e tij, duhanet me ngrohje ose purat.
- Rritje e pagave për sektorin e shëndetësisë me 7%.
- Rritje e pagave për sektorin e arsimit 7%.
- Rritje e pagave për sektorin e mbrojtjes 7%.
- Rritje e pagave për sistemit penitenciar 7%.
- Rritje e pagave për punonjësit e përfaqësive diplomatike 20%.

Fino: 800 nëpunës marrin paga trefish më të larta se presidenti

Më shumë se 800 nëpunës të administratës shtetërore marrin paga më të mëdha se ajo e Presidentit të Republikës. Këtë fakt e ka bërë të ditur dje deputeti socialistë, Bashkim Fino, gjatë diskutimit dhe miratimit të tërësi të Buxhetit të Shtetit dhe Paketën Fiskale për vitin 2019. Duke marrë shkas nga një ndryshim në ligjin e Buxhetit të Shtetit për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Fino ka theksuar se tashmë në Shqipëri është prishur piramida e pagave, pasi Presidenti i Republikës nuk e ka më pagën më të lartë në vend. Sipas tij,



afro 800 persona të punësuar në institucione që paguhen me para publike marrin më shumë lekë se presidenti i kryeministri dhe kryetari i Kuvendit. Madje, sipas

tij këto paga shkojnë deri në trefish të pagës së presidentit. "Ne miratojmë një pagë të deputetit, ndërkohë që kemi një fashë me 800 veta që marrin dyfishin apo trefishin e pagës së presidentit apo të kryeministrit. Pak më parë i dhamë dhe ca fonde të tjera Fondin e Zhvillimit Shqiptar, vazhdoni i jepni fonde të tjera ndërkohë që ai merr dyfishin e rrogës tënde tui kryetar, dyfishin e rrogës të kryeministrit dhe të presidentit. Ndërkohë që ky nen nuk respekton hierarkinë e pagave dhe ne po fusim një nen të tillë në Buxhetin e Shtetit", tha Fino.



Gjatë një seance parlamentare

PAGAT

Unë kam qëndruar ashtu si shumica e grupit parlamentar dhe shumica e qeverisë, në pozicionin që as andej, as këtej. As me idenë që të zbrisim më poshtë tek 150 mijë lekëshi, sepse bie ndesh me një parimësi që e kemi vendosur që në fillim dhe as me idenë që të fillojmë dhe të zërojmë mbi 300 mijë lekëshin", theksoi kryeministri.

Basha: Buxheti i katastrofës, mbi 73 mijë biznese ulën qepenat

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, akuzoi dje qeverinë "Rama" se ka falimentuar biznesin. Sipas tij, organizata kriminale e Rilindjes miratoi buxhetin më katastrofik të pluralizimit. Basha tha se nga 2014, mbi 70 mijë biznese kanë mbyllur qepenat me Ramën në pushtet. "Ky biznes falimenton se janë rritur kostot e biznesit, vetëm në Tiranë ka shkuar deri në 7-fish taksat vendore. Këto para shkojnë për fasada, luks qeveritar dhe elektoral. Paratë e shqiptarëve po bëhen rrrush e kumbulla", theksoi z.Basha. Sipas tij, buxheti i shtetit për 2019 "është një veteaktakuzë që organizata kriminale e Rilindjes ka ngritur për veten e saj". "Është buxheti më katastrofik në 28 vjet, ngarkon me borxh edhe foshnjat e sapolindura. Sot ka një borxh të deklaruar së bashku me llogaritje e KLSH prej afro 74% dhe ka një borxh tjetër që e mban të fshehur; borxhi i PPP që ka shkuar mbi 2.2 miliardë euro. Shqiptarëve borxhi u shkon 82-84%. Ndërkohë që ka parashikuar vetëm 40 milionë euro për të pangrënë", theksoi kreu i PD-së. Basha parashittoi edhe alternativën e PD-së për të nxjerrë vendin nga kriza në të cilën sipas tij e ka futur mazhoranca e majtë. "Kemi një alternativë për të nxjerrë vendin nga kjo krizë, alternativa është e taksës së sheshtë 9%, si domoshmëri për të konkurruar me rajonin. Vendosijen e një tavani, ku nuk mund të ngrihen taksat e pushtetit vendor. Eliminimin e menjëhershëm të taksës së qarkullimit. Rikthimi i fashave mbrojtëse për energjinë elektrike për shtresat në nevojë. Anulimi i të gjitha koncesioneve korruptive. Të harrojnë se do ti gëzojnë paratë që kanë marrë apo ato para që parashikojnë të marrin", tha z.Basha.

AKUZA

"Mbi 73 mijë biznese të mbyllura që kur Rilindja ka ardhur në pushtet që prekin 150 mijë familje shqiptare. Ky është rezultat i drejtpërdrejt i frymës mbylëse për ekonominë që ka shkakuar qeveria e Edi Ramës", tha kreu i PD.

Shitje me Ankand te trete nga Studio Permbartimore L.D.C

*1. "Ndertesë", me sipërfaqe 600 m², me Nr. Pasurive 495/15, Volum 5, faqe 83, ndodhur në Zonen kadastrale 3426 me adresë në Tulline, Tiranë. Regjistruar në Zyren Vendore Regjistrimit Pasurive Palaajtshme Tiranë. Çmimi fillestar për shitje është 2.116.800 lekë.

Data e shpalljes 30.10.2018
Data e zhvillimit 03.11.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbartimore L.D.C me adrese Rruga "Myslim Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.



Ministri i Ekonomisë dhe Financave: Ky është buxheti më i lartë në historinë e Shqipërisë

Miratohet buxheti, Ahmetaj: Shpërblim për pensionistët

“Rritja ekonomike, 4-fish nga gropa e vitit 2013”

Ashu si edhe çdo vit tjetër edhe për festat e këtij fund viti qeveria do të shpërndajë një bonus për të gjithë pensionistët. Masa e shpërblimit do jetë në masën e 5 mijë lekëve të reja dhe lajmin e dha vetë ministri i Financave, Arben Ahmetaj gjatë një konference për mediat të mbajtur mbrëmjen e djeshme. “5 mijë lekë të reja për çdo pensionist. Nuk ka pasur të tillë dhe në vitet që vijin do ta kthejmë në një politikë buxhetore”, tha Ahmetaj, ndërsa nuk dha më shumë detaje rreth këtij vendimi. Ministri i Ekonomisë dhe Financave duke folur për buxhetin e miratuar theksoi se ky është buxheti më i madh deri tani dhe buxheti i rritjes ekonomike dhe uljes së borxhit publik. Sipas numrit një të financave borxhi publik pritet të shkojë në nivelin 65.5%.



Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Arben Ahmetaj

ardhura deri në 5 milionë lek dhe taksën 5 për qind deri në 14 milionë. Kështu që kjo është e zgjidhur”, tha Ahmetaj. Por pavarësisht kësaj, Braçe ka mundur të marrë mbështetjen e 12 deputetëve që kanë votuar pro amendamentit të tij, ndërsa 15 të tjerë abstenuan. Gjithashtu, shumica qeverisëse hodhi poshtë edhe propozimin tjetër të kryetarit të Komisionit të Ekonomisë për të rritur nga 15 në 30 për qind tatimin mbi lojërat e fatit që do zhvillohen nëpër resortet. “Nga momenti që kemi vendosur kufizimin që ky aktivitet do të ushtrohet vetëm në këto struktura ne e kemi dhënë incentivën. Tashmë është kreu legjitim që të ketë një normë të re tatimore”, tha Braçe. Por ministri Ahmetaj tha se mbajtja e këtij niveli të tatimit për këtë kategori është pjesë e një incentive që qeveria bën për investitorët që duan të përfshihen në industrinë turistike. Pjesë e këtij debati u bë edhe kryeministri, i cili mbështeti logjikën e ministrit të tij dhe duke dalë kundër Braçes. “Sot nuk mund të taksojmë asgjë, sepse praktikisht i bie të taksojmë asgjë”, tha kryeministri. Gjithësesi edhe ky propozim i Braçes ka marrë 6 vota pro dhe 11 abstenuan. Debatimi më pas u zhvendos në një nga pikat më të nxehta dhe që, në fakt, përbënte interes për një numër të madh nëpunësish që marrin paga deri në 40 mijë lek. Braça ashtu si në komision, ripropozoi që të rritej fasha e pagave të pa tatueshme nga 30 në 40 mijë lekë. “Ne duhet të mbrojmë të ardhurat e ulëta për çdo familje”, tha Braçe. Ndërsa ministri i Financave kundërshtoi sërish duke sqaruar se taksimi i atyre që marrin nga 30 deri në 40 mijë lekë është simbolik pasi kap shifrën e 1.9 përqind. “Është një taksim simbolik vetëm për të qenë simbolik sistem”, tha Ahmetaj. Edhe në këtë debat u përfshi sërish kryeministri, i cili kërkoi që fasha prej 30 mijë lekësh të mos ndryshojë. Me shumicë votash edhe ky propozim i Braçes u rrëzua.

pakëtës fiskale për vitin 2019, cka është shoqëruar edhe me debate mes tij dhe ministrit të Financave, Arben Ahmetaj. Zhvillimeve në seancë plenare i ka paraprirë një debat i ndodhur në grupin parlamentar socialist, ku Braçe dhe Ahmetaj janë përplasur në lidhje me propozimin për të rritur fashën e pagave që nuk tatohen nga 30 mijë lekë në 40 mijë lekë të vjetra. Burime nga grupi parlamentar bën me dije Braçe kishte deklaruar në mbledhje se propozimin e tij do ta bënte në seancë, ndërsa ministri i Financave kishte këmbëngulur se kjo do të sillte një

përfshi këtu edhe disa amendamente shumë të rëndësishme që kishin të bënin me disa grupe të caktuara interesi. Kështu, me kërkesë të Ahmetaj Kuvendi rrezoi dy propozime të Braçes që kishin të bënin rentën minerare dhe lehtësimin e barrës tatimore për sektorin e librit. “Për t’i ardhur në ndihmë këtij sektori jetik të këtij vendi sa i përket djes kam propozuar që të ardhurat e përfutuara nga personat fizik ose juridik që ushtrojnë funksionet tërësisht në shitjen e librave të jenë të përjashtuar apo ta kenë tatimin mbi fitimin zero. Bëhet

AHMETAJ

“Buxheti 2019 është buxheti më i madh në historinë e Shqipërisë me 519 miliardë lekë, afërsisht rreth 500 milionë dollarë, i cili i paraprin rritjes ekonomike të 2019, e planifikuar në nivelin 4.2 -4.3 %, pra një rritje ekonomike 4-fish nga gropa e varfërisë, viti 2013, siç e kemi quajtur”.

kosto të ndjeshme në Buxhetin e Shtetit. Nën këtë klimë debatesh e diskutimesh nisi më pas edhe seanca plenare, ku fillimisht ministri i Financave për të ulur ndoshta edhe tonet e debatit pranoi propozimin e Erjon Braçes për të mos ndryshuar tarifën doganore. Por vetëm kaq, pasi më pas të gjitha propozimet e bëra nga Braçe u rrëzuan,

fjalë për libraritë dhe librashitësit. Kjo na bën nder”, tha Braçe. Por Ahmetaj duke kundërshtuar këtë propozim u shpreh se ai është i panevojshëm pasi të gjitha bizneset deri në 5 milionë lekë taksohen me zero lekë. “E kemi realizuar këtë që thotë zoti Braçe me kohë pasi i kemi dhënë biznesit taksën zero me të

SHKURTE

PD kundër amnistisë në burgje: Elektorale

Partia Demokratike kundërshton propozimin e qeverisë, cka do të pamundësojë miratimin e amnistisë në burgje, ku do të përfitonin rreth 600 të dënuar. Deputeti, Ervin Salianji, njëherazi anëtar i Komisionit Sigurisë, deklaroi dje se qeveria e ka bërë traditë që amnisti të tilla të sjellë çdo vit, dhe këtë radhë tha ai lidhet me zgjedhjet vendore. “Nisma nuk ka ardhur akoma në parlament, po diskutohet ende nga qeveria apo Ministria e Drejtësisë që është Ministria përgjegjëse për të bërë kalkulimet e fundit apo për të zgjedhur se cilët njerëz kanë më shumë vota. Kjo nisim është më shumë propagandistikë dhe elektorale, sesa një nisim që ka qëllime të mira”, -theksoi deputeti i PD-së. Ka një moment kur Partia Demokratike do të ishte pro amnistisë. “Pa diskutim që PD do të ishte e hapur për një amnisti nëse flitet për persona të varfër apo të pamundur që janë arrestuar për shkak të pamundësisë për të paguar energjinë elektrike apo për shkak të suvatimeve pa leje”, -deklaroi z.Salianji.

Katastrofat natyrore, Meta në Samitin e Klimës të OKB-së

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, mori pjesë dje në Samitin e Klimës “COP24” të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që po zhvillohet në Katowicë të Polonisë. Në fjalimin drejtuar krerëve të shteteve dhe qeverive pjesëmarrëse, Meta theksoi “rëndësinë e balancës pozitive me zhvillimit të qëndrueshëm dhe masave tranzitore që ulin efektin sërë”. Kreu i shtetit po ashtu ndau edhe shqetësimin e qytetarëve shqiptarë, të cilët vuajnë pasojat e katastrofave natyrore prej ndryshimit klimatik. “Shqipëria, si një vend mesdhetar, është mjaft e ndjeshme ndaj ndryshimeve në trendet klimaterike, ndaj ngjarjeve të shpeshta dhe ekstreme që ndikojnë në shumë rajone, sektorë të turizmit dhe të energjisë, por mbi të gjitha mbi jetën e popullit tonë. Këto dukuri kanë rritur vetëdijën tonë dhe janë ndeshur me përgjigjen tonë të thjeshtë, por të vendosur: për të vazhduar me zbatimin e shpejtë të Marrëveshjes së Parisit”, -tha Meta.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përbarimorë "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 28 dhjetor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përbarimorë do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë "MUSHIQI" shpk të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës. Frona përbëhet nga dy dyqane (gjithej rreth 245 m2) dhe tre apartamente (gjithej rreth 245 m2) dhe mbi këto pronë nuk rëndon barrë hipotekore apo nuk janë të kullizuara nga detyrime të tjera.

Çmimi fillestar për çdo apartament do të jetë 34.000 lek/m2, ndërsa çmimi fillestar për dyqan do të jetë 51.000 lek/m2.

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përbarimorë "E.G Ballif Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Ruova, Pal64, Hyqja 8, Ap.1, Tirane, njofton se më datë 14.12.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandin i I-rë për shitjen e pasurisë të paluajtshme, Trulli me sipërfaqe totale 112 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr.pasurie 161136, Votë, Fq.122, ZK.8518 në pronësi të Shoqëria "ADRIATIKA BETON" Sh.P.K. me vlera fillestare në ankand 11.645 (Njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) EURO dhe Pasuri e paluajtshme, Trulli me sipërfaqe totale 1260 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr.pasurie 16235, Votë, Fq.236, ZK.8518 në pronësi të Shoqëria "ADRIATIKA BETON" Sh.P.K. me vlera fillestare në ankand 131.040 (Njëqind e shtatëzet e një mijë e dyzet) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580 + 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERBARIMORË GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA NR. 2/69+2-14, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 8, FAQE 218, SIPERFAQE 85 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ILIMI SULA.

ÇMIMI 5.445.148, 8 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 12.12.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Trupi i pajetë i 63-vjeçarit u gjet i hedhur në një kanal anës rrugës

Vrasja e shqiptarit në Korfuz, mediat greke: U ekzekutua nga anëtari i 'Agimit të Artë'

Viktima Petrit Zifile debatoi në lokal për çështje etnike, 44-vjeçari grek e qëlloi me çifte

GREQI

Një javë pas vrasjes së një 63-vjeçari shqiptar në Korfuz, mediat greke kanë publikuar identitetin e viktimës, ndërsa kanë dhënë detaje të reja në lidhje me ngjarjen. Ato raportojnë se personi që më 25 nëntor të këtij viti u gjet i pajetë në një kanal anës rrugës është Petrit Zifile, i cili është vrarë nga një anëtar i Agimit të Artë. Ngjarja ndodhi më 25 nëntor në Dragotina, Korfuz. Siç thonë banorët të zonës, Zifile ishte konfliktuar me fjalë një ditë para vrasjes në një lokal të fshatit me autorin për çështje të karakterit etnik. Autori i ngjarjes rezultoi pikërisht 44-vjeçari nga Korfuzi, që është anëtar i Agimit të Artë në Lefkimi, madje në zgjedhjet e fundit ka qenë kandidat me partinë ekstremiste, që kohët e fundit bën thirrje në zonë për të terrorizuar e ndjekur të huajt. Mësohet se vrasësi kishte hapur debat në lokal për çështjen e emrit të Maqedonisë, duke marrë shkas nga marrëveshja mes dy vendeve. Ai ofendonte Maqedoninë dhe qytetarët e tjerë jo grekë. Në debat e sipër ka ndërhyrë edhe shqiptari Petrit Zifile. Mes të dyve ka nisur konflikti, ndërsa 44-vjeçari e ka kërcënuar me vrasje 63-vjeçarin shqiptar, të cilin në Greqi e quanin Petro. Për të shuar sherrin, kanë ndërhyrë klientët e tjerë që ndodheshin në lokal. Më pas autori është larguar nga lokali dhe ka shkuar të merrte armën. Ai i ka ngritur kurth shqiptarit dhe

KOINONIA
Έγκλημα με άρωμα Χρυσής Αυγής στην Κέρκυρα



e ka qëlluar atë për vdekje me çifte, ndërsa trupin e viktimës e ka hedhur në një kanal në anë të rrugës, që u gjet një ditë më pas nga kalimtarë të rastit. Banorët e zonës thanë se shqiptari Petrit Zifile jetonte prej vitesh në Korfuz dhe nuk

kishte konflikte me askënd. Mediat lokale kanë ngritur problemën e personave me prirje nacionaliste, sikurse janë ata të Agimit të Artë, ndërsa vdekjen e shqiptarit e kanë konsideruar si një "vrasje fashiste". Ndërkaq,

dje policia e vendit fqinj bëri me dije se 44-vjeçari grek ka pranuar krimin për arsye banale, por nuk ka dorëzuar akoma çiften e gjahut që kishte me lejen përkatëse, e me të cilën pranoi se vrau 63-vjeçarin shqiptar.

KONFLIKTI

Mësohet se vrasësi kishte hapur debat në lokal për çështjen e emrit të Maqedonisë dhe qytetarët e tjerë jo grekë. Në debat e sipër ka ndërhyrë edhe shqiptari Petrit Zifile. Mes të dyve ka nisur konflikti, ndërsa 44-vjeçari e ka kërcënuar me vrasje 63-vjeçarin shqiptar, të cilin në Greqi e quanin Petro. Për të shuar sherrin kanë ndërhyrë klientët e tjerë që ndodheshin në lokal. Më pas autori i ka ngritur kurth shqiptarit dhe e ka qëlluar atë për vdekje me çifte, ndërsa trupin e viktimës e ka hedhur në një kanal.

SHKURT

Plagoset me thikë 20-vjeçari, në kërkim autori

SHKODER - Një 20-vjeçar ka mbetur i plagosur me thikë pasditen e djeshme në Shkodër. Burime zyrtare nga policia vendore bënë me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 15:45 pranë shkollës pyjore, në lagjen "Tre Heronjtë" të këtij qyteti, ndërsa ende nuk dihen motivet. Mësohet se i plagosuri është Niko Podja, i cili është dërguar në spital me 4 plagë në trup, ndërsa ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Policia është vënë në ndjekje të autorit të dyshuar Aus Zef Pali, 27 vjeç dhe po punon për kapjen e tij. Ndërkaq, vijojnë hetimet për zbardhjen e plote të rrethanave dhe motivit të ngjarjes.

I gjendet kallashnikov e fishekë në banesë, prangoset i riu

TRIANË - Jashar Hysa ka përfunduar në prangat e policisë, pasi iu gjet në banesë një kallashnikov si dhe një sasi fishekësh. Burime zyrtare nga blutë e kryeqytetit bënë me dije se 30-vjeçari, banues në fshatin Varosh, akuzohet për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe e municionit". Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe e municionit".

Kontrolli, bllokohen kapsolla dhe fishekzjarrë

FIER - Viojnë kontroll në dyqane dhe pika shumicash, në bazë të planit të masave për parandalimin dhe sekuestrimin e kapsollave dhe lëndëve piroteknike me rrezikshmëri për jetën. Në qytetin e Fierit, Lushnjës, Dytjakës dhe Ballshit u kontrolluan 65 subjekte të ndryshme (dyqane, supermarkete dhe pika shumicash). Si rezultat i kontroleve janë sekuestruar 210 kapsolla dhe 410 fishekzjarrë, që dyshohet se kanë në përberje lëndë shpërthyes me rrezikshmëri për jetën.

Arrestohet biznesmenit Bardhok Pllanaj, i sekuestrohet ndërtesa me vlerë 2 milionë euro

SHKODËR - Pas një hetimi disa muajor, policia e Shkodrës ka vënë në pranga biznesmenin Bardhok Pllanaj, banues në fshatin Shtoj i Vjetër, pasi akuzohet për pastrim parash, falsifikim të vulave, stampave ose formularëve dhe ndërtim pa leje. Mësohet se 44-vjeçari i përfolur më parë për trafik droge që prej disa vitesh kishte filluar ndërtimin për qëllime përfitimi të një objekti 10-katësh pa marrë më parë leje nga organet përkatëse. Sipas bluve, nga hetimet e kryera ka rezultuar se ky objekt me vlerë rreth 2 milionë euro është financuar nga paratë e siguruarra përmes burimeve kriminale, ndërsa pallati në fjalë është vënë nën sekuestro preventive. Ndaj biznesmenit Pllanaj, dje gjykata e Shkodrës ka vendosur masën e sigurisë "Arrest me burg".

ARRESTIMI

Sipas burimeve nga policia e Shkodrës, arrestimi i Bardhok Pllanajt u bë pasi me datë 03.12.2018 nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit në



Policia e Shkodrës

bazë të Vendimit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku ndaj këtij shtetasi është caktuar masa e sigurimit "Arrest me burg", për veprat penale: "Pastrimi i produkteve të veprës penale", "Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve", "Ndërtim pa leje". Policia në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pas një hetimi disa muajor bënë të mundur dokumentimin e aktivitetit kriminal të shtetasit Bardhok Pllanaj, i cili prej disa vitesh kishte filluar ndërtimin për qëllime përfitimi të një objekti 10-katësh pa u pajisur me lejet përkatëse të lëshuara

nga organet kompetente. Gjatë hetimeve të kryera ka rezultuar se ky objekt është financuar nga të ardhura që dyshohet që kanë ardhur si rrjedhojë e aktivitetit kriminal që ka kryer ky shtetas më parë, e për këtë arsye është vendosur dhe masa e sigurimit pasuror me vendim gjykatë "Sekuestro preventive", në bazë të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimit Penal nr:1169 datë 29.11.2018, për objektin 10-katesh që ndodhet në qytetin e Shkodrës në pronësi të tij, objekt, i cili kap vlerën 2 milion euro Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.



Në "listën e zezë", dhe Hamdi e Zylfije Haklaj

Policia nxjerr listën, ja 15 personat më të kërkuar në qarkun e Kukësit

KUKËS - Policia e Shtetit ka publikuar dje listën e 15 personave më të kërkuar në qarkun e Kukësit. Në këtë listë është edhe Zylfije dhe Hamdi Haklaj, të cilët kanë fituar azil në Suedi. Zylfije Haklaj është e dënuar me 25 vite burg, pasi mori hak për vëllezërit, duke vrarë dy persona. Ajo akuzohet për vrasjet e Rasim Lumneshit dhe Ilir Gosturanit. Ngjarje kjo e ndodhur në vitin 2002 në Tropojë. Në "listën e zezë" është edhe Hamdi Haklaj, ndaj të cilit Gjykata ka vendosur dënimin me 25 vjet burg. Ai akuzohet për vrasjen e vëllezërve, Besim e Guxim Demaj dhe Halil Hoxhës në '98-ën. Blutë u bëjnë thirrje qytetarëve që të bashkëpunojnë për të dhënë informacion, ndërsa garantojnë ruajtjen e anonimatis. "Ja personat e kërkuar nga Policia në qarkun e Kukësit. Policia e Shtetit fton cilindo që ka dijeni mbi vendndodhjen e tyre të telefonojnë policinë në numrin pa pagesë 112, duke ju garantuar anonimatin. Ndihmo dhe ti në sigurinë publike", thuhet në njoftimin e Policisë së Shtetit.

TIRANË - Prokuroria e Krimeve të Rënda ka ankimuar vendimin për Emiljano Shullazin dhe 4 bashkëpunëtorët e tij, të dënuar 3 javë më parë me 55 vite burg. Gjykata nuk e gjeti fajtor këtë grup për të gjitha episodet për të cilat i akuzonte prokuroria. Sipas gjykatës, nuk kishte prova që Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Endri Qyja, Endri Zela dhe Blerim Shullazi të kishin kërcënuar dy profesorët Dhori Kule dhe



Banda "Shullazi" në sallën e gjyqit

Gjykata dha pafajësi për dy akuza, prokuroria ankimoi vendimin për Emiljano Shullazin dhe 4 bashkëpunëtorët

Mënyr Koni, me qëllim që ky i fundit të tërhiqej nga gara për rektor. Gjithashtu, për togat e zeza nuk faktohej se ishin këta persona ata që kishin hedhur tritol në biznesin e Adriatik Kërçukut në Lushnje. Por, Prokuroria pretendon të kundërtën sepse edhe këto dy raste sipas tyre janë të provuara me fakte. Gjykata e Shkallës së Parë për

Krimet e Rënda dënoi me 14 vite heqje lirie Emiljano Shullazin, i cilësuar nga prokuroria kreu i grupit kriminal. Me 12 vite u dënua Gilmando Dani, 10 vite u dhanë për Endri Qyjen dhe Endri Zelën, ndërsa për Blerim Shullazin 9 vite burg. Këta persona në bashkëpunim me njëri-tjetrin i kanë marrë biznesmenit Ylvi Beqja 550 mijë euro dhe

30% të ish-hotel "Vollgës" në Durrës me anë të kërcënimeve. Ata u gjetën fajtorë edhe për kërcënimin e biznesmenit Jani Zaka, me qëllim marrjen e një parkimi në Tiranë. Ndërsa, një ankimim në Gjykatën e Apelit kanë bërë dhe avokatët e të akuzuarve, të cilët kërkojnë pafajësinë e klientëve të tyre. TV "Klan".

Babai i 22-vjeçarit: Autorët janë kontingjent kriminal, kërkojmë dënim maksimal

TIRANË

Në gjykatën e Tiranës është zhvilluar dje seanca gjyqësore e radhës ndaj katër të akuzuarve për vrasjen me thikë të Marvi Mihalit. Ngjarje kjo e ndodhur në korrik të vitit që shkoi për një karikues telefoni. Në këtë seancë kanë dëshmuar prindërit e viktimës, të cilët u shprehën se e dinë kush janë autorët e vrasjes së djalit të tyre dhe se ata janë një kontingjent i rrezikshëm kriminal. "Kam parë me qindra dhe mijëra herë videon e vrasjes së djalit tim. Personi që e qëlloi është Dejvi Bitraj". Kështu deklaroi nga salla e gjyqit Pavlo Mihali, babai i 22-vjeçarit Marvi Mihali. Gjatë fjalës së tij, i ati i viktimës (ish-rekordmen i kërcimit me shkop), tha se të akuzuarit ishin nisur për të vrarë natën e sherrit dhe se ishin të gjithë të armatosur. "Kam fakte që vrasësit e tim biri janë kontingjent kriminal. Ditën e ngjarjes kam qenë në Sarandë dhe jam njoftuar nga kunati im. Dejvi Bitraj e ka qëlluar pasi Eugen Bitraj e ka goditur nga pas dhe rruazuar në tokë. Dënimi duhet të jetë maksimal", u shpreh ai. Ndërkohë, Fatmira Mihali, nëna e 22-vjeçarit, tha se besonte te drejtësia dhe se do luftonte deri në fund, ndërsa shtoi se nëse nuk ndodhte kjo gjë, do të bënte vetëgjyqësi. "Dua të sqarohem se nuk do të ketë kurrë gjyq për dëm-

Vrasja e Marvi Mihalit, nëna: Nuk ka dëmshpërblim që më zëvendëson djalin

"Kam besim te drejtësia dhe do luftoj deri në fund, në të kundërt do bëj vetëgjyqësi"



22-vjeçari Marvi Mihali

shpërblim. Nuk ka vlerë që më zëvendëson djalin. Në ngjarje Marvi ka hyrë vetëm për të ndarë dy veta. Eugen Bitraj e tërhoqi nga pas dhe

er rrëzoi. Ata ishin përgatitur për të vrarë. Do vrisnin këdo që do u dilte para. Kam besim tek drejtësia dhe sa të kem jetë do luftoj. Askush

nuk mund të dalë i pa lagur nga kjo histori", pohoi nëna e viktimës. **NGJARJA** Marvi Mihali u vra më 31

DEKLARATA E PAVLO MIHALIT

Kam parë me qindra dhe mijëra herë videon e vrasjes së djalit tim. Personi që e qëlloi është Dejvi Bitraj". Kështu deklaroi nga salla e gjyqit, Pavlo Mihali, babai i 22-vjeçarit Marvi Mihali. Gjatë fjalës së tij, i ati i viktimës (ish-rekordmen i kërcimit me shkop), tha se të akuzuarit ishin nisur për të vrarë natën e sherrit dhe se ishin të gjithë të armatosur.

karikuesin. Pas debateve mes Haxhiut dhe Bitrajve është vendosur që të takohen për t'u sqaruar tek "Dinamo". Haxhiu ka kërkuar që aty të shkonte edhe miku i tij, Marvi Mihali dhe pas shumë telefonatash, ka arritur ta bindë këtë të fundit. Sapo ka mbërritur Mihali, Haxhiu ka goditur me grusht një prej të dyshuarve, ndërsa Marvi ka ndërhyrë për t'i ndarë dhe aty është goditur me thikë nga Deji Bitraj. Familjarët kërkuar që dy kushërinjtë, Dejvi dhe Eugen Bitraj dhe vëllezërit Kridens dhe Marsel Alla, të përgjigjen për akuzën e vrasjes me paramendim në bashkëpunim, sepse sipas tyre i kanë ngritur kurth Marvit.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR SHOQUAR ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje 5 copë makina sortimi për nevojat e degëve të Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar shoqëruar me ftesa direkte kandidateve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 40,365,000 Lekë ose 323,700 Euro".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshtkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje 5 copë makina sortimi për nevojat e degëve të Bankës së Shqipërisë"

Oferata duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 08 Janar 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje pajisje dhe aksesorë të sistemeve të mbrojtjes elektronike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 3,718,400 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshtkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje pajisje dhe aksesorë të sistemeve të mbrojtjes elektronike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferata duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 10 Janar 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

URDHRI I FARMACISTEVE DOKUMENTACIONI

Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë: Kontrata tip, të drejtat e detyrat mes palëve

Voltiza Duro

Deri në 7 dhjetor të këtij viti, të diplomuarit për Farmaci kanë afat të kryejnë regjistrimin për kryerjen e praktikës profesionale për sezonin dhjetor 2018-mars 2019. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot dokumentacionin që duhet të dorëzojnë të interesuarit pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë. Përkatesisht aplikantët duhet të paraqesin kërkesën, vetëdeklarimin, si dhe kontratën tip për kryerjen e praktikës profesionale. Gjithashtu, ata duhet të dorëzojnë edhe fotokopjen e certifikatës së anëtarësimit në UFSH të drejtuesit të praktikës; fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave; fotokopje të kartës së identitetit; një raport mjekoligjor; fotokopjen e plan-vendosjes së farmacisë; tre fotografi (3x3.5 cm); si dhe mandat pagesën në shumën 10000 lekë, në numrin e llogarisë 69623 pranë bankës BKT. 'Regjistrimet për kryerjen e praktikës profesionale për sezonin dhjetor 2018 - mars 2019 do kryhen gjatë periudhës 03 - 07 dhjetor 2018. Praktika profesionale kryhet në farmacitë e rrjetit të hapur ose spitalore, nën drejtimin e një farmacisti me jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune (Një farmacist drejton vetëm një praktikant)

Orari i kryerjes së praktikës është 8:00 - 14:00. Personat që janë diplomuar në ish- Universitetin "Kristal" duhet të paraqesin vërtetimin e vlefshmërisë së diplomës, lëshuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë". -thekson UFSH në njoftimin e saj.

KËRKESA

'Gazeta Shqiptare' zbardh sot edhe formatin e kërkesës që duhet të dorëzojnë aplikantët pranë zyrate të UFSH-së. 'Unë i/e nënshkruari/a, pasi u njoha me Kodin Deontologjik, Statutin dhe Rregulloret e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, Behtimin e Hipokratit sipas formulimit të Gjenevës të vitit 1948, si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë Shërbimin Farmaceutik në Republikën e Shqipërisë, kërkoj të regjistrohem për kryerjen e praktikës profesionale pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, duke u zotuar për shumimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ky regjistrim". -kjo është ajo cka kandidatët duhet të deklarojnë në kërkesën e tyre.

TË DREJTAT DHE DETYRAT MES PALËVE

Në kontratën tip për kryerjen e praktikës profesionale përcaktohen edhe të drejtat dhe detyrimet që lin-


Zbardhen datat e regjistrimit për praktikën profesionale të farmacistëve

"Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët"



DOKUMENTACIONI

- Kërkesë;
- Vetëdeklarim;
- Kontratën tip për kryerjen e praktikës profesionale;
- Fotokopje e certifikatës anëtarësimit në UFSH të drejtuesit të praktikës;
- Fotokopje te noterizuar të diplomës dhe listës së notave;
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Raport mjeko-ligjor;
- Fotokopje e plan-vendosjes së farmacisë;
- Tre (3) fotografi (3x3.5 cm);
- Mandat pagesën në shumën 10000 lekë, në numrin e llogarisë 69623 pranë bankës BKT.



din për Drejtuesin e Praktikës dhe Praktikantin gjatë periudhës së kryerjes së praktikës. Drejtuesi i praktikës duhet të jetë profesionist me përvojë jo më pak se 3 (tre) vjetësh; t'i sigurojë praktikantit kushtet e nevojshme për realizimin e një praktike efektive; t'i bëjë një vlerësim të drejtë dhe të paanshëm njohurive të praktikantit dhe të pajisë praktikantit me Formularin e Vlerësimit të Praktikës; të drejtojë praktikën profesionale në përputhje të plotë me standardet, parimet dhe normat e Kodit Deontologjik Farmaceutik, si dhe me legjislacionin farmaceutik në fuqi.

Gjithashtu, ai duhet t'i kërkojë praktikantit respektimin e orarit dhe ta dokumentojë atë në librezën e praktikës profesionale; t'i kërkojë kryerjen e praktikës profesionale në përputhje me rregulloren e UFSH për praktikën profesionale. Drejtuesi i praktikës ka të drejtë të anulohet kontratën në rast shkeljeje të detyrimeve të saj nga ana e praktikantit dhe të njoftojë strukturat më të afërta të UFSH-së.

Nërkohë praktikanti duhet të respektojë Drejtuesin e Praktikës në përputhje të plotë me normat e etikës së kodit deontologjik farmaceutik; të qëndrojë në farmacinë ku kryen praktikën gjatë gjithë periudhës së praktikës, të respektojë orarin e caktuar dhe të pranojë në fund të praktikës vlerësimin e bërë nga Drejtuesi i Praktikës. Gjithashtu, praktikanti duhet të respektojë Drejtuesin e Praktikës dhe etikën e komunikimit me të dhe me pacientët. Në raste kur konstatohen veprime që bien nënshëm këto të drejta apo tjetër veprim që e pengon, krijon vështirësi apo pamundësi në zhvillimin efektiv të praktikës, ka të drejtë të ankohe tek drejtuesi i institucionit si dhe tek strukturat më të afërta të UFSH-së. Praktikanti që fiton të

drejtën e anulimit të kontratës ekzistuese, për periudhën e mbetur nënshkruan kontratë me një drejtues tjetër praktikë.

KONTRATA TIP

"Kjo kontratë është një marrëveshje midis Drejtuesit të Praktikës dhe Praktikantit në lidhje me realizimin e periudhës së praktikës. Gjatë zhvillimit të praktikës profesionale, praktikantit i paguhen sigurimet shoqërore dhe sigurimet shëndetësore nga subjekti pranë të cilit ai kryen praktikën profesionale. Palët duhet të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që mund të lindë si rrjedhojë e zbatimit të kësaj

kontrate", theksohet në nenin 5 të kontratës për kryerjen e praktikës profesionale. Kjo e fundit hartohet në tri kopje me fuqi të njëjtë ligjore, nga të cilat një për secilin palë dhe një depozitohet në Urdhriin e Farmacistëve. Palët e lexojnë dhe pasi pranojnë e bien dakord me kushtet e kësaj kontrate, e nënshkruajnë atë, në dhe për interes të qëllimeve profesionale që përfaqësojnë.

7

DHJETOR AFATI

Regjistrimet për kryerjen e praktikës profesionale për sezonin dhjetor 2018 - mars 2019 do kryhen gjatë periudhës 03 - 07 dhjetor 2018. Praktika profesionale kryhet në farmacitë e rrjetit të hapur ose spitalor, nën drejtimin e një farmacisti me jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune (Një farmacist drejton vetëm një praktikant).

Ministri i Diasporës rrëfen debatin me kryeministrin për shembjen e "Teatrit"

Majko: Ramës i çova dorëheqjen në zyrë, ja pse ndryshova mendje "Moskandidimi i Veliajt? Edi do dëmtonte veten, jo Erionin"

Adi Krasta

Ministri i Diasporës, ish-kryeministri dhe deputeti socialist Pandeli Majko ka qenë dje në emisionin "A show", në News24, për të folur për shumë tema, që nga marrëdhënia me kryeministrin Edi Rama, tek ekonomia, Partia Socialiste e deri te çlirimi.

Në një intervistë ndryshe, me nota humor, ironie dhe plot lakime të fjalëve Majko tregoi dhe për një kontratë mes tij dhe kryeministrin Edi Rama.

Ministri zbardhi disi dhe debatin me kryeministrin pas replikave në parlament për çështjen e Teatrit Komëtar. Majko nuk preferoi të tregonte debatin, por tha se kishte një kontratë për të mos bërë interesantin.

Çfarë frazash janë shkëmbyer mes teje dhe kryeministrin në parlament për çështjen e Teatrit? Çfarë i the e çfarë të tha?

E pse duhet ta them tani këtë.

Në interes të publikut. Po nuk më duket me kaq interes.

Ka pasur një shkëmbim batutash?

Sigurisht kemi shkëmbyer, dallohet qartë dhe në TV, nuk besoj se përbën një sekret kjo.

Pse, për shembull e merrti tani në kuptimin, si e merr pyetjen time, përse nuk dëshiron që të paktën të thuashe çfarë i the, jo çfarë të tha?

Po kam një kontratë me kryeministrin.

Një kontratë që thotë që nuk duhet të flasësh?

Jo, s'është të bëj interesantin më shumë se ç'duhet.

Ti ia lejon kryeministrin të bëjë interesantin më shumë se ç'duhet?

Në marrëdhënie me?

Në marrëdhënie me ty ose me të tjerët?

Unë e kam mik, në radhë të parë e kam mik. Kjo është arsyeja pse jam në qeveri, kjo është arsyeja se pse pranova të bëhem ministër edhe pa më të thënë.

I ke bërë ndonjë pyetje vetes Pandi pse kryeministri ka ndaj teje një sjellje relativisht si më tënë jo domosdoshmërisht të përdullur, por të kujdesshme. Si me tënë, me çfarë mund ta kishte trembur ti atë?

Me asgjë. Unë të nesërmen shkova i dorëzova dorëheqjen.

Të cilën ai nuk e pranoi duke thënë çfarë?

Unë nuk kisha ndër mend ta pranoja mospranimin e tij, por boll disa fjalë që nuk vinin nga kryeministri, por vinin nga Edi, që unë të thashë e kam mik, më ndryshuan mendjen.

Ti ke një informacion që nëpër tavolina miqësore, në mënyrën e të folurit të natyrshme, familjare, private të kryeministrin, p.sh. mund t'ia kishte lejuar që ia të tregojë një anekdotë në raport me ty,



Ministri i Diasporës Pandeli Majko, dje në emisionin "A show", në News24

por duke e pikturuar me ngjyrime tipike të Ramës, jo domosdoshmërisht të respektueshme?

Po ju të dëgjoni anekdotat që them unë për të pastaj në prani të tij. Kështu që mos kujtoni se unë nuk ia kthej me të njëjtën monedhë. Por këto janë gjëra të cilat funksionojnë mes dy miqsh.

Dua të të bëj disa pyetje në raport me qeverisjen. Ne nuk e kuptojmë shumë mirë se çfarë ndodh aty brenda. Para se të fillonte transmetimi ti më the se aty është një zyrë, pra zyra e kryeministrin ku ke qenë dhe ti, me gjemba. Bëhet kjo zyrë me gjemba më e vështirë për një zyrë që nuk janë të përgatitur për të qenë vizionarë, dhe të përgjegjshëm dhe të ndërgjegjshëm në punën e tyre apo në atë zyrë kanë të gjithë një lloj suksesi?

Besoj që ka diçka që këtu mund ta diskutojmë, por do të ishte një diskutim shumë i gjatë. Shkurt është një arsye që quhet arsye shtetërore. Arsyeja shtetërore dhe marrëdhënia njerëzore shpesh herë janë të ndryshme. Nga ndonjëherë ajo që quhet e moralshme në arsyen njerëzore në arsyen shtetërore quhet e pavlefshme ose e pamoralshme. Kështu që ne duhet të kuptojmë që në zyrë me gjemba si ajo e kryeministrin shpesh të nxit të shkosh në një drejtim tjetër nga ajo që njerëzisht të tjerët presin të ndodhë nga ty.

Ti je pjesë e asaj që sot quhet qeverisja si "Rilindje"?

Jo unë i them shkurt "RL" por...

Pra, je pjesë e "RL"-së?

Do më hanë kokën kolegët kur ta dëgjojnë këtë intervistë, nëse e dëgjojnë. Problemi është i tillë. Nuk besoj që ka një diferencë mes një rilindasi dhe një socialisti. Në thelb janë disa

elementë që në një moment të caktuar të fushatës elektorale u shprehën. Por që mua të më thuash ke diferencë nga një kolegu jot që është më i ri dhe po e quajmë rilindas, kjo do ishte qesharake.

Po ti si e ndjen veten më shumë socialist apo rilindas?

Tek unë s'ka asnjë diferencë.

Mund të konsiderohet Rilindja në analizën e përgjithshme, parë nga kritikët e saj si një sekt i mbyllur dhe shumë i kujdesshëm për të realizuar disa elemente qeverisjeje që jo domosdoshmërisht kanë qenë tipikisht socialiste dhe tipikisht të establishmentit socialist të partisë.

Po e thellojmë atëherë... Janë këta të gjithë këta, kjo koperturë njaftisto rilindase etj., etj. një sekt mason...metodologji mase që mbliiden diku dhe ndajnë hesapet se çfarë do bëjmë.

Shiko që mbliiden diku dhe ndajnë hesapet kjo është e padiskutueshme. Se ku, hajde ta flasim?

Më bërë pyetje që unë të jap një variant të përgjigjes që ke ti në kokë?

Absolutisht, dua një përgjigje që ke ti në kokë.

Mendoj që nuk funksionon kështu. Mbase ne jemi të prirur të shikojmë atë që na duket si e re pak e dyshimtë. Aktualisht në PS ka një prurje goxha të madhe sidomos pas 2013. Dikush mund t'i quajë rilindas, dikush mund t'i quajë me një emër tjetër, ç'rëndësi ka. Ata janë produkti i asaj që po prodhon PS në pushtet. Sot janë prodhim i pushtetit, nesër mund të jenë prodhim i ti qenit në opozitë. Në thelb kështu krijohen politikanët. Nuk krijohen në mënyrë tjetër, si ofte.

Ti e mban mend dinamikën se si i ndodhi PD-

PER EDI RAMEN
Unë e kam mik, në radhë të parë e kam mik. Kjo është arsyeja pse jam në qeveri, kjo është arsyeja se pse pranova të bëhem ministër edhe pa më të thënë.

së, fuqia e njëshit, forcimi i një establishmenti që ndihmonë nëshin për të qenë autoritarist dhe për të realizuar vizionin e vet jo vetëm të partisë dhe që çfarë po ndodh sot me PD-në. Në qoftë se Pandi do të thoshin ty që janë konstatuar të njëjtët elementë, domethënë fuqizimi i një grupimi në shërbim të njëshit, lënia mënjane, ngrënia bar o ofrimi i barit si ushqim për një pjesë tjetër, të cilët duhet të mbushin salla, të mbushin atmosfera zgjedhjes etj., mund t'i ndodhi kjo socializim?

Kur je në pushtet kjo ndodh. Sepse kalon, nga të qenit në opozitë ke një politikë që quhet horizontale dhe një ditë pasi vjen në pushtet ajo horizontajla fillon prishet sepe fillon vertikajla e pushtetit që bën presion. Ke qenë krah për krah me dikë të cilin e konsideroje të barabartë. Sot ti je po i njëjti, ai tjetri është bërë drejtor, po është prefekt a, është bërë zëvendësministër, po është bërë ministër dhe kjo fillon dhe rëndon tek marrëdhënia njerëzore apo tek marrëdhënia politike që vjen nga horizontajla dhe pastaj kalon tek vertikajla.

Sipas analizës tënde e ka mbyllur ciklin Partia Socialiste në pushtet?

Jo. Dhe bëmë pak humor para se të fillonte emisioni. Dakord i heqim, pyetja tjetër është kë do vëmë?

Jo mos u shqetësoni kë do vëmë. Hajde bëjmë analizën e asaj se si është situata. Sipas mendimit tënd personal zoti ministër dhe ish-kryeministër, gjendja ekonomike e Shqipërisë si të duket? Është shqetësim? Është Shqipëria e varfër? Ka probleme të forta me ekonominë, pra me lekun?

Mendoj se kanë ndryshuar të paktën dy gjëra. Ka

ndryshuar marrëdhënia e qytetarit me ekonominë. Nuk janë më qytetarët që diskutonin ekzistencializmin e viteve '90. Sot jo të gjitha punët mund të jenë punë të kërkua në Shqipëri dhe një pjesë e familjeve në një mënyrë a një tjetër bëjnë një jetë të dyfishtë. Në ç'kuptim të dyfishtë?! Dikush ka një vëlla, dikush ka një motër, dikush ka një kushëri apo një fëmijë që është jashtë vendit. Afërsisht gjysma e popullsisë është jashtë dhe i njëjtë është me Gjermaninë, me SHBA-të, me Kanadanë ka rritur presionin dhe sot ti nuk ke njerëz që bëjnë kërkesa për të qenë diçka më mirë se ç'kanë qenë. Ti sot ke kërkesa për të qenë një qytetar evropian normal.

Pse ikin njerëzit nga Shqipëria?

Edhe për këtë arsye që sapa thashë.

Në kërkim të një jete më të mirë?

Absolutisht. Por nuk jam naiv dhe dua ta pohoj që jemi akoma një shoqëri jo evolutive. Një pjesë e njerëzve të suksesshëm nuk gjejnë suksesin këtu. Njerëz të cilin në na duken të zakonshëm, papritur shkojnë në Itali, në Kanada dhe bëhen të suksesshëm.

Ne mendojmë se qeveria duhet të japë llogari për të gjitha, sapa kaluam kufirin, por problemi është që ta fillojmë nga ajo që sapa thashë. Jemi ende një shoqëri joevolutive, ku njeriut të suksesshëm jemi të gatshëm t'i hapim rrugën.

Ti përdore fjalën "unë nuk jam naiv" dhe unë kam këtë mendim për ty që ti ke pasur dhe ke një lloj intelligence konjitive që të ka bërë të pozicionohesh në mënyrë interesante gjatë këtyre 30 viteve. Nuk është rastësi që një njeri është bërë kryeministër, është deputet në mënyrë të konsoliduar. Pikërisht në momentin kur ndoshta askush nuk e dinte ç'është diaspora krijohet artificialisht një pozicion që të kënaqim Pandi Majkon, i cili mund të akuzohet për një lloj naiviteti në sjelljen ndaj njerëzve të pushtetshëm brenda PS. Është kështu?

Jo. Diaspora është ndoshta projekti më i rëndësishëm. Jo kjo qeveri, por dhe qeveritë më pas do duhet ta kenë. Është kështu siç po e them unë. Nëse do ishte një projekt për një njeri atëherë do ishte për të ardhur keq.

Çfarë raporti ke ti me

zotin Veliaj?

Raport të mirë pune.

Mund të ndodhë që nëpër takime, nëse ti do kishe marrë një njoftim që një grup njerëzish brenda PS me në krye kreun e bashkisë së Tiranës që domosdoshmërisht të kërkon që të jetë konkurrenca edhe këtë herë për bashkinë e Tiranës dhe nëse ndodh kështu ai e fiton betejën. Pra, nëse ka një grupim, i cili kërkon të bëjë një ndryshim politik brenda PS. Pra, t'i marrë Ramës pozicionin e partisë me shpresën që më pas të bëhet kryeministër. Këtë aksion, ti e mbështet, nuk e mbështet, e kundërshton apo je inerti?

Si ta përkthejë unë këtë. Mendon që Erion Veliaj, të abstraktojmë bashkë, do kërkojë t'i zërë vendin Edi Ramës duke qenë Rama në kokë të vet kryeministër i Shqipërisë?

Po.

Të lutem. Nuk besoj. Nuk ndodh.

Nuk beson apo nuk ke informacion.

Nuk ndodh.

Mund të ndodhë që kryeministri të mos e vendosë Veliajn për kryetar të Tiranës dhe nëse ndodh pse duhet ta bënte?

Nuk kam informacion e kam dëgjuar si thashethem. Por mendoj se Rama do dëmtonte veten më shumë se sa Erionin.

Mund të ma shpjegoni, si do dëmtonte veten? Pra, Manastirliu shkon për bashkinë e Tiranës dhe Veliaj...?

Nga e ke këtë informacion?

Nuk kam informacion. Thashë po abstragoj në emër të spektaklit. Thashë ta supozojmë.

Po meqë po supozojmë gjej një emër tjetër, o vëlla. (qesh)

Më pëlqen relaksimi dhe qetësia që ke fituar me kalimin e vetive. Ti je gati për një pozicion të dytë kryeministërlëku. Meqë ra frylla do ta kishe bërë ndryshe?

Unë kam qenë dy herë kryeministër.

Për të tretën. Prapë?

Po.

Mund ta kishe bërë ndryshe?

Rri... Mos na hap sherre (qesh)

Unë kam vënë re që ju i trembeni sherreve. Psh. ti ke shkëmbyer zëna me drejtuesit e lartë të PS?

Sa herë të duash. Por nuk do isha ky që jam po të mos kisha bërë debate.

Kush nuk e ka dorëzuar, duhet të sjellë llogarinë bankare dhe fotokopje ID

Kësti i tretë i dëmshpërblimit, emrat dhe dosjet e përfituesve

Trashëgimtarët e parë dhe të dytë që marrin paratë

Ministria e Financave ka publikuar listën emërore të trashëgimtarëve të ish-të prindëkurve politikë të cilët duhet të dorëzojnë numrin e llogarisë bankare dhe një fotokopje karte identiteti ose pasaporte në mënyrë që të marrin paratë e dëmshpërblimit. Për ata që kanë një llogari aktive bankare dhe e kanë dorëzuar fotokopjen e mjetit të identifikimit, nuk ka nevojë që ta bëjnë këtë veprim përsëri.

"Lista emërore me subjektet përfituese të kështit të tretë, të cilët duhen të perditesojnë numrat e llogarisë bankare dhe fotokopje të mjetit të identifikimit. Trashëgimtarët eniveli të parë dhe të dytë, të dosjeve të mëposhtëme, të cilët janë në radhë pagese për kështin e tretë, duhet të depozitojnë pranë zyrave tona vërtetimin e numrit AKTIV të llogarisë bankare si edhe fotokopje mjet identifikimi", thuhet në njoftimin e ministrisë së Financave.

125	552	1699	Xhelal Çapuni	ME BURG
126	553	707	Samit Guri	ME BURG
127	558	1699	Ibrahim Cania	ME BURG
128	562	707	Vullnet Baja	ME BURG
129	564	1699	Baki Koçi	ME BURG
130	570	1147	Ahmet Pepmarku	ME BURG
131	571	707	Fatime Matjani (Bajaziti)	ME BURG
132	573	784	Ismail Mena	ME BURG
133	574	784	Hamdi Picari	ME BURG
134	585	1147	Isen Mulla	ME BURG
135	591	707	Myslim Zoto	ME BURG
136	596	707	Qerim Lumani	ME BURG
137	602	707	Lazër Prendi	ME BURG
138	603	1699	Gjok Dacaj	ME BURG
139	618	1147	Alush Kashari	ME BURG
140	622	1699	Nikoll Zagorjani	ME BURG
141	629	707	Qerim Hysaj	ME BURG
142	632	707	Ziadin Ftera	ME BURG
143	639	784	Ahmet Agasi	ME BURG
144	649	784	"Skënder"" Taçi"	ME BURG
145	655	707	Hasan Sakollari	ME BURG
146	663	1699	Xhemal Zhegu	ME BURG
147	672	1699	Luc Gjelij	ME BURG
148	674	1699	Lake Tyrku	ME BURG
149	680	1699	Bani Bozo	ME BURG
150	682	784	"Zef"" Deda"	ME BURG
151	687	1699	Xhevat Dosku	ME BURG
152	693	1699	Fuat Ballo	ME BURG
153	694	1699	Sali Balla	DENIM

EMRAT ME PERFITUESIT E KESTIT TE TRETË TE PERNDJEKURVE

Nr.	NR	Dosje	VKM	Emer Mbiemer	Tipi Denimit	64	237	784	Hysen Deda	ME BURG
1	1	707		Syrja Vrap	ME BURG	65	242	784	Pano Lapa	ME BURG
2	5	784		Petro Taku	ME BURG	66	244	1699	Hajdar Selita	ME BURG
3	7	1699		Elami Hado	ME BURG	67	247	1699	Tefik Çepele	ME BURG
4	9	1231		Lumturi Bakiri	ME BURG	68	248	784	Ruxhdi Osmanagiq	ME BURG
5	10	1699		Thoma Jorgo	ME BURG	69	257	707	Dod Veshitja	ME BURG
6	12	707		Fehmi Frashëri	ME BURG	70	270	707	Teki Canka	ME BURG
7	14	707		Enver Allmuça	ME BURG	71	273	1147	Marie Tuci	ME BURG
8	18	1699		Selim Koçi	ME BURG	72	280	784	Idriz Muco	ME BURG
9	20	1699		Fiqiri Muhaj	ME BURG	73	282	784	Hasan Gjata	ME BURG
10	21	707		Reshat Qosja	ME BURG	74	284	1699	Karaman Paftali	ME BURG
11	22	784		Mustafa Peposhi	ME BURG	75	287	1699	Tuni Bare	ME BURG
12	27	784		Ahmet Beqaj (Beqo)	ME BURG	76	289	1699	Foto Nikdhima	ME BURG
13	28	1699		Xhelal Alija	ME BURG	77	290	784	Gjetë Bajraktari (Paçuku)	ME BURG
14	34	1699		Qemal Xhili	ME BURG					ME BURG
15	36	707		Jonuz Peça	ME BURG	78	292	1699	Daut Bylyku	ME BURG
16	38	784		Militiadh Feshti	ME BURG	79	294	1259	Rakip Haderi	ME BURG
17	39	1699		Nevrus Bello	DENIM	80	295	707	Muhamrem Kotorri	ME BURG
					KAPITAL	81	298	784	Alqiviadh (Alqiviadh) Kuçuli	ME BURG
18	47	1699		Gjergj Bubani	ME BURG					ME BURG
19	49	1699		Beqo Kamberaj	ME BURG	82	310	784	Myfit Troka	ME BURG
20	53	1259		Sherif Pema	ME BURG	83	314	784	Aleksander Dilo	ME BURG
21	54	1699		Shefqet Hazizolli	ME BURG	84	315	784	Nikolle Qafa	ME BURG
22	56	1699		Riza Selmani	ME BURG	85	317	1231	Qamil Kruija	ME BURG
23	59	1699		Llambi Shani	ME BURG	86	324	784	Emin Jero	ME BURG
24	61	1699		Kalosh Kola	ME BURG	87	336	1231	Ahmet Lleshanaku	ME BURG
25	63	784		Sulejman Baçi	ME BURG	88	342	1699	Estref Shkurti	DENIM
26	69	707		Simon Hila	ME BURG					KAPITAL
27	71	784		Petrit Mançe	ME BURG	89	344	1699	Milo Duni	ME BURG
28	73	1699		Mehmet Selmani	ME BURG	90	347	784	Hamza Myrto	ME BURG
29	76	1699		Pal Brozi	ME BURG	91	361	707	Kristo (Shyqyri) Qahhaj	ME BURG
30	78	1699		Haki Pepa	ME BURG					ME BURG
31	80	1699		Çaush Balliu	ME BURG	92	364	1699	Ndrec Marku	ME BURG
32	85	1699		Fetah Molla	DENIM	93	368	1699	Leonidha Kume	ME BURG
					KAPITAL	94	377	1699	Sadush Avdullari	ME BURG
33	89	784		Shahin Musaj	DENIM	95	381	1699	Zef Brungaj	ME BURG
					KAPITAL	96	383	1699	Zija Xhumri	ME BURG
34	92	707		Shefqet Kau	ME BURG	97	387	1699	Nezir Doçi	ME BURG
35	95	707		Njazi Pilku	DENIM	98	389	1699	Thanas Tingo	ME BURG
					KAPITAL	99	395	707	Gjylsime Preza	ME BURG
36	96	707		Hetem Hyska	ME BURG	100	397	707	Ibrahim Dervishi (Dobrenji) ME BURG	
37	99	707		Martin Priska	ME BURG					DENIM
38	100	707		Shefqet Koseni	ME BURG	101	401	1699	Mustafa Kurani	DENIM
39	101	707		Gani Palla	ME BURG					KAPITAL
40	119	784		Kristaq Nushi	ME BURG	102	403	784	Vexhi Xhaferi	ME BURG
41	125	784		Nazmi Bica (Bicaj)	ME BURG	103	407	1699	Metali Alite	ME BURG
42	129	784		Sotiraq Andoni	ME BURG				Hoxha	ME BURG
43	136	1699		Sul Harri	ME BURG	105	417	784	Pal Qafza	ME BURG
44	137	1699		Xhemal Lani	ME BURG	106	418	707	Ndrec Marku	ME BURG
45	147	1147		Ndue Ndrecaj	ME BURG	107	422	1699	Mehmet Hoxha	ME BURG
46	152	784		Islam Mezzini	ME BURG	108	423	784	Seid Lila	ME BURG
47	167	1147		Mezan Abazi	ME BURG	109	425	784	Gjon Marsh	ME BURG
48	168	784		Ferdin Rami	ME BURG	110	436	1699	Seid Mansaku	ME BURG
49	169	1699		Sherif Koçi	ME BURG	111	441	784	Seit Alimeta	ME BURG
50	172	1699		Avni Zhiti	ME BURG	112	444	784	Bahri Abazi (Bari)	ME BURG
51	173	1699		Estref Myrteza	ME BURG	113	451	784	Jakup Shalësi	DENIM
52	174	707		Rexhep Sijami	ME BURG					KAPITAL
53	178	1699		Ibrahim Thika	ME BURG	114	460	707	Petrit Spahiu	ME BURG
54	182	1699		Kristaq Andoni	ME BURG	115	462	784	Rudolf Dhima	ME BURG
55	184	1699		Petro Spiru	ME BURG	116	464	784	Hazbi Laçi	ME BURG
56	189	1699		Kapllan Biçaku	ME BURG	117	475	784	Kristaq Veliu	ME BURG
57	190	1699		Skënder Barçi	ME BURG	118	481	784	Dilaver Xhemali	ME BURG
58	192	1699		Pal Gjoka	ME BURG	119	487	1699	Xhemal Djaloshi	ME BURG
59	198	784		Bajram Haxhiq	ME BURG	120	506	1699	Haki Bulku	ME BURG
60	204	1699		Gëzim Petrela (Zani)	ME BURG	121	512	707	Jorgji Papajani	ME BURG
61	222	784		Rexhep Stafa	ME BURG	122	514	1699	Piro Piqoni	ME BURG
62	225	784		Bezat Aliko	ME BURG	123	520	1699	Mersin Cërriku	ME BURG
63	234	1699		Avdulla Hoxha	ME BURG	124	540	784	Kolë Ndoci	ME BURG

154	701	1147	Fuat Maska	ME BURG
155	708	707	Sali Bajrami	ME BURG
156	709	1699	Pandeli Zografi	ME BURG
157	713	707	Pjetër Gurakuqi	DENIM
				KAPITAL
158	718	1699	Pano Taçi	ME BURG
159	719	707	Tefik Deliallisi	DENIM
				KAPITAL
160	722	1699	Baftjar Shutina	ME BURG
161	726	707	Teqi Caco	ME BURG
162	729	707	Gëzim Konica	ME BURG
163	734	1699	Lulo Ismaili	ME BURG
164	739	707	Sali Sulaj	ME BURG
165	740	1699	Hasan Kalaja	ME BURG
166	742	1699	Hilmi Saillari	ME BURG
167	750	1699	Hifzi Kelmendi	ME BURG
168	759	1699	Xhelal Projë	ME BURG
169	761	1699	Sulo Bega	ME BURG
170	764	1147	Mustafa Malaj	ME BURG
171	767	707	Hamit Collaku	ME BURG
172	773	707	Emrulla Gazidede	ME BURG
173	774	707	Ferdinand Kakarriqi	ME BURG
174	792	1699	Gani Tatari	ME BURG
175	798	784	Hamdi Vata	ME BURG
176	802	784	Zybi Çuçaj	ME BURG
177	805	1699	Jaho Rustem	ME BURG
178	808	784	Hamid Myrta	ME BURG
179	817	1699	Hazis Rexhepi	ME BURG
180	823	1699	Hasan Kukulaj	ME BURG
181	825	1699	Sulejman Ruçi	ME BURG
182	828	1699	Kazma Muço	ME BURG
183	831	1699	Mersin Alla	DENIM
				KAPITAL
184	836	1699	Latif Bekteshi	ME BURG
185	837	1699	Seit Taho	ME BURG
186	846	1699	Ibrahim Shote	ME BURG
187	847	784	Durim Shyti	ME BURG
188	860	707	Mark Pepa	ME BURG
189	866	1699	Martir Kupi	ME BURG
190	879	1699	Kadri Bali	ME BURG
191	881	1699	Sami Pashaj	ME BURG
192	883	1699	Adem Pira (Piri)	ME BURG
193	884	1699	Xhemal Dashi	ME BURG
194	885	1699	Mark Marku	ME BURG
195	887	1699	Xhevat Muçejani	ME BURG
196	888	1699	Zabit Noka	ME BURG
197	889	1699	Lili (Ili) Çomo	ME BURG
198	890	1699	Muharrem Xhixha	ME BURG
199	893	1699	Isuf Sollaku	ME BURG
200	894	1699	Gani Çala	ME BURG
201	903	1699	Demir Dema	ME BURG

202	912	784	Halil Allçi	ME BURG	287	1393	707	Mark Dema	ME BURG	374	2073	784	Prel Gurraj	ME BURG
203	913	1147	Zeqir Koçi	ME BURG	288	1394	707	Atnan Baholli	ME BURG	375	2076	707	Ali Zoto	ME BURG
204	927	707	Osman Gjyshja	ME BURG	289	1401	707	Ibrahim Haxhini	DENIM	376	2077	707	Iljaz Zoto	ME BURG
205	929	784	Mehmet Suli (Cuni)	ME BURG					KAPITAL	377	2083	707	Xhevdet Kabashi	ME BURG
206	932	784	Gjok Gobeti (Gjoka)	ME BURG	290	1403	1147	Minella Jorgoni	ME BURG	378	2086	784	Mirash Preka	ME BURG
207	933	1231	Isuf Fusha	ME BURG	291	1408	784	Riza Hatija	ME BURG	379	2094	784	Thoma Budo	DENIM
208	935	707	Kamber Daija (Laçe)	ME	292	1410	707	Haxhi Ajce	ME BURG					KAPITAL
				BURG	293	1413	1699	Tefik Gabrani	ME BURG	380	2117	784	Prek Hysaj	ME BURG
209	937	1147	Shaqir Çullhaj	ME BURG	294	1426	1699	Selami Baruti	ME BURG	381	2126	1699	Gjyste Jaku	ME BURG
210	955	707	Ksanthipi Stefa (Konini)	ME	295	1441	1699	Idriz Doda	ME BURG	382	2134	707	Sokrat Lapa	ME BURG
				BURG	296	1456	707	Fatmir Kadiu	ME BURG	383	2144	707	Qemal Shehu	ME BURG
211	956	784	Ndrek Pepa	ME BURG	297	1457	707	Estref Guri	ME BURG	384	2151	1699	Shyqyri Laçe	ME BURG
212	959	784	Mihal Zallari	ME BURG	298	1465	784	Metush Hoxha	ME BURG	385	2153	1699	Petrit Hoxha	ME BURG
213	961	784	Todi Lubonja	ME BURG	299	1478	784	Nikoll Virjoni	ME BURG	386	2181	784	Gjekë Gekaj	ME BURG
214	963	707	Skënder Zyka	ME BURG	300	1491	784	Miço Nathanaili	ME BURG	387	2183	784	Xhemal Dylli	ME BURG
215	965	1231	Habib Neli	ME BURG	301	1501	1699	Rasim Kozarja	ME BURG	388	2189	784	Gjon Matrizi	ME BURG
216	973	784	Jakë Kola	ME BURG	302	1507	1147	Josif Kristani	ME BURG	389	2193	707	Faik Hoxha	ME BURG
217	974	707	Preke Elezi	ME BURG	303	1514	1699	Abdyll Kërluku	ME BURG	390	2205	707	Nezir Vjerdha	ME BURG
218	979	1147	Nikëlqim Kurti	ME BURG	304	1533	1259	Skender Gumbardhi	ME BURG	391	2217	784	Jorgaq Diamanti	ME BURG
219	987	707	Gjergji Taçi	ME BURG	305	1548	1699	Dede Palaj	ME BURG	392	2218	707	Amir Kuqo	ME BURG
220	990	784	Petrit Arkaxhiu	ME BURG	306	1550	1699	Ramadan Dajlani	ME BURG	393	2222	707	Jorgji Kondi	ME BURG
221	997	784	Pashko Curaj	ME BURG	307	1552	1699	Mahmut Meta	ME BURG	394	2226	1699	Cin Serreqi	DENIM
222	1006	784	Sabri Tabaku	ME BURG	308	1555	707	Qamil Krosi	ME BURG					KAPITAL
223	1011	784	Nikolla Gerço	ME BURG	309	1558	784	Kristo Ziu	ME BURG	395	2228	1699	Frook Dedaj	ME BURG
224	1021	707	Hamdi Pengili	ME BURG	310	1592	784	Xhelal Batra	ME BURG	396	2232	784	Gjovalin Mirashi	ME BURG
225	1041	784	Rako Stefaj	ME BURG	311	1595	784	Frano Rushaj	ME BURG	397	2241	1699	Faik Hardalli	ME BURG
226	1047	1147	Kujtim Xhaja	ME BURG	312	1634	1699	Mirush Permeti	DENIM	398	2243	784	Nikoll Pepaj	ME BURG
227	1050	1699	Rexhep Kulla	ME BURG					KAPITAL	399	2248	707	Veli Ballolli	ME BURG
228	1056	1699	Avdi Pëposhi	ME BURG	313	1640	1699	Hamit Spaho	ME BURG	400	2268	1147	Dajlan Shigarasi (Shukarasi,	DENIM KAPITAL
229	1058	707	Shefqet Murrija	ME BURG	314	1643	1699	Islam Ristani	ME BURG				Radovicka)	
230	1065	707	Pjerin Martini	ME BURG	315	1644	1699	Hamdi Virjoni	ME BURG	401	2281	1699	Shyqyri Aliko	ME BURG
231	1066	1699	Murat Basha	DENIM	316	1645	1259	Hajredin Qojle	ME BURG	402	2287	1699	Mustafa Lusha	ME BURG
				KAPITAL	317	1656	1259	Hajdar Vehbi	ME BURG	403	2288	1699	Burhan Golemi	ME BURG
232	1069	1699	Arqile Melo	ME BURG	318	1658	1259	Rustem Bitri	ME BURG	404	2290	1699	Jakup Tahiraj	ME BURG
233	1071	1699	Destan Kaloshi	ME BURG	319	1665	1699	Gafur Tefik	DENIM	405	2291	1699	Stavro Laboviti	ME BURG
234	1077	1699	Izem Sejdi	ME BURG					KAPITAL	406	2297	1699	Bajram Haka	ME BURG
235	1080	1699	Ihsan Qereshniku	ME BURG	320	1675	707	Baftjar Kapiti	ME BURG	407	2316	1699	Neshat Hasho	DENIM
236	1082	1699	Sabri Osmani	ME BURG	321	1676	707	Muhamet Haremi	ME BURG					KAPITAL
237	1087	1699	Dule Taifa	ME BURG	322	1680	784	Jak Ndokaj	ME BURG	408	2323	1699	Bajram Bitri	ME BURG
238	1091	1231	Hamit Kulla	ME BURG	323	1686	707	Fetah Aliçka	ME BURG	409	2330	784	Avdi Gjoshi	ME BURG
239	1107	784	Ibrahim Leshi	ME BURG	324	1704	784	Xhelal Khamrija	ME BURG	410	2335	1699	Isuf Çela	ME BURG
240	1108	707	Hajredin Kulemani	ME BURG	325	1713	1147	Aqif Selimi	ME BURG	411	2339	1699	Kamber Bejko	ME BURG
241	1114	784	Beqir Omari	ME BURG	326	1721	1699	Riza Çaçeli	ME BURG	412	2342	1699	Preng Gjegjia (Milici)	ME BURG
242	1121	1699	Pjetër Gjoka (Vila)	DENIM	327	1731	1699	Sejat Tare (Tarelli)	ME BURG	413	2344	1699	Arif Tabaku	DENIM
				KAPITAL	328	1732	784	Mark Leka	ME BURG					KAPITAL
243	1125	784	Nazmi Cenolli	ME BURG	329	1737	1699	Vasfi Koçibelli	ME BURG	414	2347	1699	Hazis Noka	ME BURG
244	1126	1147	Ajet Petritaj	ME BURG	330	1750	1699	Tafil Xhelaj	ME BURG	415	2349	784	Rako Shore	ME BURG
245	1127	1699	Kurtish Restelica	ME BURG	331	1765	1699	Thoma Masho	ME BURG	416	2352	707	Pashko Dokaj	ME BURG
246	1133	1699	Mexhit Methasani	DENIM	332	1772	784	Koço Kajo	ME BURG	417	2359	1699	Nikoll Miloti	ME BURG
				KAPITAL	333	1773	1699	Shyqyri Pasho	ME BURG	418	2363	1699	Londihia Zguri	ME BURG
247	1137	707	Petraç Kolovani	ME BURG	334	1795	784	Shuko Alikaj	ME BURG	419	2366	1699	Dashmir Shehu	ME BURG
248	1152	1699	Hasan Agolli	ME BURG	335	1797	707	Rexhep Plaku	ME BURG	420	2370	707	Alush Koleci	ME BURG
249	1165	707	Ndue Përzefi (Çoku)	ME BURG	336	1801	1699	Idriz Byberi	ME BURG	421	2381	1699	Hamit Kroj	ME BURG
250	1168	1699	Selaudin Xhaxho	ME BURG	337	1802	1699	Fiamur Mullaj	ME BURG	422	2383	707	Fatmir Ceka	ME BURG
251	1172	1699	Todi Nako	ME BURG	338	1811	707	Tefik Neli	ME BURG	423	2385	707	Rustem Skëndi (Skënderi)	ME BURG
252	1183	1699	Marko Lacka	ME BURG	339	1812	707	Osman Abdiaj	ME BURG					BURG
253	1184	707	Hysni Dashi	ME BURG	340	1817	707	Islam Tare	ME BURG	424	2391	707	Riza Alizoti	DENIM
254	1187	1699	Sako Protoduari	ME BURG	341	1823	784	Mustafa Freskina	ME BURG					KAPITAL
255	1191	707	Dode Lleshi	ME BURG	342	1833	1147	Hajdar Qerreti	ME BURG	425	2395	1699	Ali Sadrija	ME BURG
256	1193	1699	Dodë Vorfi	ME BURG	343	1848	784	Tafil Luka	ME BURG	426	2399	707	Ismail Qaushi	ME BURG
257	1207	1699	Ymer Patozi	ME BURG	344	1862	707	Merset Maluka	ME BURG	427	2409	1699	Ahmet Sadria	ME BURG
258	1211	784	Vasil Cacanis	ME BURG	345	1864	784	Osman Ajazi	ME BURG	428	2413	1699	Fadil Xhindi	ME BURG
259	1213	1699	Agron Hifziu	ME BURG	346	1879	707	Adem Taçi	ME BURG	429	2425	1699	Halit Gjoleka	ME BURG
260	1216	1147	Myrto Burgaj	ME BURG	347	1889	784	Filip Laska	ME BURG	430	2434	1699	Elmaz Kallapodhi	ME BURG
261	1231	707	Hajri Nevlin	ME BURG	348	1891	1699	Pashuk Tanazaj	ME BURG	431	2447	784	Skender Çela	ME BURG
262	1235	707	Petrit Aslanaj	ME BURG	349	1925	707	Muharrem Hysenbegasi	ME	432	2449	1699	Shefqet Myftarli	ME BURG
263	1246	784	Ramazan Kashari	ME BURG					BURG	433	2456	1699	Islam Biçaku	ME BURG
264	1257	707	Muharrem Sina	ME BURG	350	1927	707	Ali Nuredini	ME BURG	434	2464	1699	Ekuran Shyti	ME BURG
265	1268	784	Feti Gremi	ME BURG	351	1929	1699	Fadil Zeneli	ME BURG	435	2470	707	Hasbi Lamce	ME BURG
266	1270	1231	Avni Haxhijaj	ME BURG	352	1930	1147	Habil Gjoni	DENIM	436	2473	1699	Ramazan Stermasi	ME BURG
267	1275	707	Pjetër Lushi	ME BURG					KAPITAL	437	2484	707	Gjon Sufaj	ME BURG
268	1276	1147	Ramazan Guri	ME BURG	353	1933	1699	Bib Marku	ME BURG	438	2485	1699	Nikoll Sefgini	ME BURG
269	1287	1231	Shyqyri Ahmetaga	ME BURG	354	1939	1231	Namik Bardhi	DENIM	439	2500	784	Xhemal Hoxha	ME BURG
270	1298	1699	Mane Mamunanaj	ME BURG					KAPITAL	440	2501	1699	Ivan Cani	ME BURG
271	1323	1699	Aben Qalliu	ME BURG	355	1945	707	Hafuz Kaboçi	ME BURG	441	2503	1699	Rexhep Lloçi	ME BURG
272	1324	1699	Shyqyri Abazi	ME BURG	356	1950	784	Ullis Deliu	ME BURG	442	2504	707	Mus Çuka	ME BURG
273	1333	1699	Bujar Doku	ME BURG	357	1951	1699	Mhill Bushgjokaj	ME BURG	443	2505	784	Hamdi Sefa	ME BURG
274	1338	707	Ahmet Lleshi	ME BURG	358	1955	784	Liço Çalaj	ME BURG	444	2506	1699	Foto Dilo	ME BURG
275	1346	1699	Kadri Llixha	DENIM	359	1957	707	Çuman Çarçani	ME BURG	445	2507	707	Qerim Deliaj	ME BURG
				KAPITAL	360	1958	707	Bashkim Fisha	ME BURG	446	2508	784	Bexhet Ballij	ME BURG
276	1356	1231	Llambi Kondo	ME BURG	361	1975	784	Pjetër Gjoni	ME BURG	447	2513	1699	Shaqir Vorpsi	ME BURG
277	1361	1699	Agathokli Papastathi	ME BURG	362	1976	707	Fahri Kaso	ME BURG	448	2514	1699	Haxhi Abazi	ME BURG
278	1362	1699	Fatime Demçe (Trafiku)	ME	363	1988	1231	Koli Knezi	ME BURG	449	2522	1699	Ali Rapaj	ME BURG
				BURG	364	1999	784	Hamdi Ukthaçi</						

Komisioneri i BE për Zgjerim: Dy vendet duhet t'i rikthehen dialogut

Taksa ndaj Serbisë, Hahn: Kosova po pengon zbatimin e CEFTA-s

Lista Serbe kërkon takim me eurokomisionerin

Ditën e djeshme, komisioneri i Bashkimit Evropian për Zgjerim, Johannes Hahn, vizitoi Kosovën. Në fokus të takimeve të tij ishte vendimi i qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksës 100% për mallrat nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Hahn gjatë kësaj vizite do të takohet me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi; kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli; kryeministrin Ramush Haradinaj si dhe liderët e opozitës. Pritet që gjatë vizitës së tij, Hahn të përsërisë thirrjen për revokimin e taksës dhe të nënvizojë nevojën për fokusim në përmirësimin e marrëdhënieve fqinjësore dhe bashkëpunimin rajonal. Ndërkaq, pas takimit me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vučić, komisioneri për Zgjerim, Johannes Hahn ka shkruar në "Twitter" se kanë diskutuar për tarifën 100% për mallrat nga Serbia dhe Bosnja që futen në Kosovë, ku thuhet se po pengohet zbatimi i marrëveshjes së CEFTA-s dhe REA-së, sa i përket bashkëpunimit rajonal. Ai ndër tjera ka shkruar se gjatë takimit me presidentin serb janë pajtuar për tejkalimin e situatës së krijuar. Hahn gjithashtu njoftoi se do t'u bëjë thirrje bashkëbiseduesve në Kosovë që të zhbllokohen bashkëpunimin dhe tregtinë rajonale, duke theksuar kështu nevojën që t'i kthehen dialogut. Nga ana tjetër, deputetët e Listës Serbe po qëndrojnë në Kuvend, duke kërkuar takimin me Hahnin me të cilin duan të bisedojnë për tarifën e vendosur ndaj importeve që vijnë nga Serbia. Ndërkohë, edhe deputetët serbë, që përfaqësohen përmes Listës Serbe, që nga e diela janë mbyllur në Kuvend me kërkesën që ta takojnë komisionarin Hahn dhe t'i shpjegojnë atij qëndrimin dhe shqetësimet në lidhje me vendimin e qeverisë së Kosovës për taksën doganore prej 100 për qind për prodhimet me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, të cilat importohen në Kosovë. Njëri nga deputetët, anëtar i Listës Serbe, Igor Simiç tha për Radion Evropë e Lirë se kërkojnë takimin me komisionarin Hahn, në mënyrë që ta njoftojnë atë me krizën humanitare, e cila siç tha ai, po "e kërcënon popullin serb" për shkak të vendimit të Prishtinës që ta vendosë taksën prej 100 për qind ndaj produkteve serbe. "Kërkesa e vetme e deputetëve të Listës Serbe, të cilët ka mbi 22 orë që janë mbyllur në Kuvend, është që të takohemi me Johannes Hahn që t'ia transmetojmë atij shqetësimin e qytetarëve serbë në lidhje me vendimin



Komisioneri i Bashkimit Evropian për Zgjerim, Johannes Hahn

JOHANNES HAHN

"Gjatë takimit me presidentin serb jemi pajtuar për tejkalimin e situatës së krijuar me Kosovën. Do t'u bëj thirrje bashkëbiseduesve në Kosovë që të zhbllokohen bashkëpunimin dhe tregtinë rajonale, duke theksuar kështu nevojën që t'i kthehen dialogut", ka shkruar në "Twitter", komisioneri për Zgjerim, Johannes Hahn.

IGOR SIMIÇ

"Kërkesa e vetme e deputetëve të Listës Serbe, të cilët ka mbi 22 orë që janë mbyllur në Kuvend është që të takohemi me Johannes Hahn që t'ia transmetojmë atij shqetësimin e qytetarëve serbë në lidhje me vendimin e qeverisë së Kosovës, e cila në fakt ka bllokuar prodhimet e Serbisë si për serbët, ashtu edhe për shqiptarët. Kjo ngriti tensione mes qytetarëve, duke ditur se 95 për qind e mallrave në mjediset e banuara me popullatë serbe vijnë nga Serbia", tha ai. Nga ana tjetër, komisioneri i Bashkimit Evropian për Zgjerim dhe Fqinjësi, Johannes Hahn, qëndroi dje për vizitë në Kosovë. Ai pritet të zhvillojë takime me udhëheqësit më të lartë politikë të Kosovës, presidentin Hashim Thaçi, kryetarin e Kuvendit Kadri Veseli si dhe me kryeministrin Ramush Haradinaj. Një çështje tjetër, të cilën Hahn pritet ta diskutojë me autoritetet e Kosovës është edhe ajo e liberalizimit të vizave. Këshilli i Ministrave i BE-së nuk e ka vënë në agjendën e takimit të 6 dhe 7 dhjetorit çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën, çka në Prishtinë ka zgjuar reagime të shumta.

Stoltenberg: Mbështesim dialogun Beograd-Prishtinë

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s: KFOR do vijojë të jetë në Kosovë, Bosnja më afër anëtarësimit

Jens Stoltenberg, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, ka theksuar ditën e djeshme mbështetjen e aleancës që ai përfaqëson për dialogun Beograd-Prishtinë. Deklarata e tij është bërë në prag të takimit të shefave të vendeve anëtare të Aleancës Veri-Atlantike, i cili së bashku me përfaqësuesen e lartë të BE-së, Federica Mogherini, do të diskutojnë ditën e sotme marrëdhëniet e NATO-s me vendet e Ballkanit Perëndimor. I pyetur nga mediat nëse Aleanca Veri-Atlantike kishte frikë se një zgjidhje sigurie mund të kishte rezultuar në një zgjidhje në dialogun Beograd-Prishtinë që do të përfshinte disa korrigjime kufitare, Stoltenberg tha se NATO mbështet fuqishëm dialogun Beograd-Prishtinë, pasi është e vetmja mënyrë që të gjendet përgjigjja për çështje të pazgjidhura. "Kur është fjala për rregullimet e mundshme kufitare, theksoj se NATO mbështet dialogun dhe shpresoj që të dyja palët do të gjejnë një zgjidhje të pranueshme si për Beogradin, ashtu edhe për Prishtinën", tha Stoltenberg.



Sekretari i përgjithshëm i Nato, Jens Stoltenberg

pranueshme si për Beogradin, ashtu edhe për Prishtinën", tha Stoltenberg. Sipas tij, është e rëndësishme që të gjithë faktorët të përmbahen nga lëvizjet sfiduese dhe mesazhet provokuese dhe të përpunohen të zvogëlojnë tensionin dhe të bëjnë përparim. Ai theksoi se NATO do të vazhdojë të jetë prezente në Kosovë përmes

misionit të saj operativ, KFOR, i cili është i rëndësishëm për stabilitetin. "KFOR-i do të vazhdojë të jetë i paanshëm, në mënyrë që të jemi të sigurt se stabiliteti dhe siguria do të garantohen dhe se do të ketë përparim drejt përpjekjeve politike për të gjetur një zgjidhje përmes negociatave politike", përfundoi sekretari i

JENS STOLTENBERG

"Kur është fjala për rregullimet e mundshme kufitare, theksoj se NATO mbështet dialogun dhe shpresoj që të dyja palët do të gjejnë një zgjidhje të pranueshme si për Beogradin, ashtu edhe për Prishtinën", tha Stoltenberg.

përgjithshëm i NATO-s. "Nga Bosnje Hercegovina do të kërkojmë përgatitjen e programit të parë për vitin. Tani është në anën e autoriteteve të Bosnjës, nëse do ta pranoni këtë ofertë", ka thënë Stoltenberg. Të martën dhe të mërkurën në Bruksel do të mbahet

mbledhja e ministrave të Jashtëm të vendeve anëtare të NATO-s, ndërsa plani për Bosnjën pritet të miratohet të mërkurën. Ky është hapi i parë në procesin e anëtarësimit të plotë të këtij shteti në aleancën Aeri-Atlantike. Secilit shtet që synon anëtarësimin në NATO i kërkohet të përpilojë planin vjetor të përgatitjes për anëtarësim. Ndërkaq, nga ana tjetër, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, në konferencën para mbledhjes ministrorë në Bruksel komentoi edhe azilin e ish-kryeministrit maqedonas, Nikola Gruevski në Hungari. Në fjalën e tij, Stoltenberg u shpreh se mbrojtja që po i jep Hungaria ish-kryeministrit nuk është një çështje e NATO-s. "Nuk jam unë, ai që duhet ta komentoj këtë. Kjo është çështje që duhet të diskutohet mes Shkupit dhe Budapestit", deklaroi Stoltenberg.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Oriola Marashi si Rasheli? Zbuloni ç'ka ndodhur mes bukurosheve

Ato janë të dyja ndër vajzat më seksi dhe të komentuar në showbiz-in shqiptar. Bukuroshet kanë rrembyer zemrat e të gjithë fansave. Po ç'ka ndodhur këtë herë? Së fundmi, Oriola Marashi ka kopjuar hapur Rashel Kolanecin me veshjen e saj. Në 'Instastories', Oriola ka postuar disa prej fotove nga ditëlindja e motrës së saj, ku duket me një jumpsuit nude. Sapo e pamë këtë veshje menjëherë na u kujtua Rashel Kolaneci, e cila e ka veshur e para këtë veshje në "Xing me Ermalin" dhe u komentua mjaft pasi të gjithë menduan se copa në ngjyrë mishi ishte transparente. Të dyja vajzat duken mjaft sensuale dhe seksi me këtë veshje dhe e kemi me të vërtetë të vështirë të themi se kujt i rri më mirë.



Sherri mes Noizyt dhe Seven Saraçit: Nëse nuk ke nga këto, nuk ta kthej diss-in

Seven Saraçi i ka habitur të gjithë pasi publikoi një foto ku tregoi një email që i erdhi nga kompania, e cila mbron të drejtat e projekteve të Noizyt, në të gjitha platformat digjitale, dhe që kërkuar të heqë nga Youtube projektin e tyre "Si me kon zezake" të publikuar në vitin 2015. "Noizy kërkon të tërheq këngën "Si me kon zezake" para 4 vitesh. Nuk mundem ta bëj tag se më ka bërë block. Te kënga "Si me kon zezake", shumë mirë e dimë që vetë ti ke dashur të hysh në këngë kur e kemi punuar në studio me Boom-in. E ke ditur që është hit për atë arsye ke hyrë si mysafir. Me të vërtetë dua të di pse je i nevrikosur? Është dashuri, është thjesht muzikë, mos u drejto nga ndjenjat Kiki, lol", shkruan Seven, i cili e ka fshirë më pas postimin. Reperi shqiptar që nuk kishte reaguar i është kthyer Sevenit dje me një postim të makinave të tij luksoze të rreshtuara njëra pas tjetrës. "Nëse nuk ke nga këto nuk do ta kthej diss-in mbrapsht" shkruan Noizy në postimin e tij. Nuk e dimë nëse Seveni do të reagojë sërish pas kësaj, por kënga "Si me kon zezake" vazhdon të jetë në kanalën Youtube.



"Kam rënë në dashuri vetëm një herë", Flori Mumajesi jep detaje për jetën private

Kantautori Flori Mumajesi prezantoi ditën e diel këngën pjesë marrëse të "Kënga Magjike". Projekti mban titullin 'Plas' dhe është një baladë mjaft e ndjerë, e cila është pëlqyer nga publiku. Gjatë mini-intervistës tek 'E diela shqiptare' ai zbuloi disa detaje nga jeta e tij personale. "Më është thyer besimi nga shumë njerëz që kam takuar rrugës. Tani kam vendosur mure të forta, por vazhdoj, dua megjithëse më është thyer besimi", tregoi Flori. Këngëtari tha po ashtu se gjatë jetës së tij ka dashuruar vetëm një herë. "Po, kam rënë në dashuri vetëm një herë dhe nuk ka të bëjë fare me showbiz-in. Njeriu një herë dashuron vërtetë në jetë", - u shpreh Flori. Kujtojmë që një nga romancat për të cilat Flori është përfolur më së shumti është ajo me Elvana Gjatën, mirëpo asnjë prej tyre nuk e ka pranuar lidhjen. Ndërsa theksoi se këngët e tij nuk janë dedikime për këtë të fundit.



Nora Istrefi "çmend" fansat me pozat seksi në klipin e ri

Bukuroshja Nora Istrefi është duke finalizuar projektin e saj më të ri, për të cilin nuk ka preferuar të tregojë shumë detaje. Përmes një fotografie të publikuar në profilin e saj në 'Instagram', këngëtarja ka zbuluar se si do të duket në një nga skenat e klipit. E veshur me një fustan të shkurtër me ngjyrë vjollcë, Nora shfaqet tejet tërheqëse. Kujtojmë që projekti i fundit nga Nora Istrefi është "As ni gotë", në bashkëpunim me Mixey, këngë me të cilën mori 4 milionë klikime në kanalën YouTube. Ka zëra se shumë shpejt do vij një bashkëpunim i suksesshëm me motrën e saj Erën, mirëpo deri atëherë na ngelet vetëm të presim.





Pamje nga protestat e 'jelekverdheve' në Francë

Rritja e taksës me 23%, vendi në krizë nga protestat për çmimin e naftës

"Jelekët e verdhë" 'mbërthejnë' Francën, bllokojnë furnizimin me hidrokarbure

Macron nuk shpall gjendjen e jashtëzakonshme

Vijon java e tretë e protestave të "jelekëve të verdhë" në kryeqytetin e Francës për shkak të rritjes së çmimit të naftës. Këta protestues në Francë po ngrenë barrierë për të bllokuar furnizimin e pikave të karburanteve me naftë. Ata po bllokojnë kalimin e autoboteve me naftë nëpër autostrada e rrugë hyrëse në qytete. Veç dhunës në shesh, kjo është një nga format për të shprehur revoltën e tyre kundër taksave të qeverisë që kanë rritur me 23% çmimin e naftës. Protestues: Barrikatat i kemi ngritur për të mos lejuar kalimin e autoboteve me naftë. Kjo është një hyrje strategjike dhe paralizon ekonominë e gjithë Bordosë. Pasaiojt e kësaj mënyre proteste kanë nisur të ndihen tek konsumatorët. Shumë pika karburantesh, kryesisht në rajonin veriperëndimor të Bretanjes, ku rezistenca është edhe më e ashpër, janë mbyllur pasi e kanë të pamundur të furnizohen. "Jelekëveverdhtë" i mbikëqyrin barrikatat përgjatë 24 orëve dhe policia e ka të pamundur në shumë raste t'i largojnë. Zona ndodhet në prag krize, para festave të fundvitit. Por, autoritetet franceze hedhin dyshime se organizatorët e protestave të dhunshme të fundjavave në Paris po mobilizojnë njerëz me precedent kriminalë. Sipas hetuesve, ata janë të mirëpërgatitur për akte dhune ku edhe vetë forcat speciale të policisë franceze e kanë pasur të pamundur t'i përballonin. Dëmi ekonomik i shkakuar përgjatë këtyre tri fundjavave, përlogarit në qindra miliona euro. Ndërkaq, ditën e diel, presidenti francez, Emanuel Macron zbriti në sheshin e "betejës", "Harkun e Triumfit" për të parë nga afër shkatërrimet një ditë pas protestës së dhunshme të të ashtuquajturve "Jelekë të verdhë". Presidentin nuk e ndalën thirrjet kundër të qindra manifestuesve që qëndronin ende në qendër të Parisit, për të protestuar kundër rritjes së çmimit të karburantit. Gjatë ditës së diel, shefi i Elizesë zhvilloi edhe një mbledhje urgjente me ministrat për situatën, por ndryshe nga ç'u lajmërua, gjendja e jashtëzakonshme nuk u shpall. Autoritetet thanë se të shtunën, mbi 100 persona u plagosën në përleshje, mes të cilëve 23 policë. Në pranga ranë mbi 400 protestues, përgjegjës për shkatërrim të ambienteve publike e



Protesta ndaj hidrokarbureve në Francë

JAVA E TRETË

Këta protestues në Francë po ngrenë barrierë për të bllokuar furnizimin e pikave të karburanteve me naftë. Ata po bllokojnë kalimin e autoboteve me naftë nëpër autostrada e rrugë hyrëse në qytete. Veç dhunës në shesh, kjo është një nga format për të shprehur revoltën e tyre kundër taksave të qeverisë që kanë rritur me 23% çmimin e naftës.

EMANUEL MACRON
"Le të mbeten me turp ata që sulmuan policinë dhe ata që ishin të dhunshëm ndaj qytetarëve të tjerë. Nuk ka vend për një dhunë të tillë në Republikë", ka shkruar Macron në "Twitter".



BENJAMIN GRIVEAUX
"Duhet të mendojmë për veprimet që duhet të ndërmarrim për të mos përsëritur këto incidente. Presidenti konsideroi të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme për të parandaluar përsëritjen e protestave të dhunshme si dhe ka bërë thirrje për bashkëbisedim me protestuesit", tha zëdhënësi, Benjamin Griveaux.



PROTESTUES
"Barrikatat i kemi ngritur për të mos lejuar kalimin e autoboteve me naftë", ka thënë një nga protestuesit të quajtur ndryshe "jelekverdhtë", të cilët me anën e kësaj hyrje strategjike paralizon ekonominë e gjithë Bordosë, pasiojt e të cilës kanë nisur të ndihen tek konsumatorët.



dyqaneve private përreth qendrës. Qindra mijëra njerëz protestojnë prej 3 javësh në të gjithë Francën kundër taksës së gjelbër që ka rritur me 23% çmimin e karburantit. Presidenti Macron akuzon protestuesit si mbështetës të

radikalëve të djathtë të Marinë Le Penit. Presidenti Macron ka theksuar se nuk ka vend për një dhunë të tillë në republikë. "Le të mbeten me turp ata që sulmuan policinë dhe ata që ishin të dhunshëm ndaj qytetarëve të tjerë. Nuk

ka vend për një dhunë të tillë në republikë", ka shkruar Macron në "Twitter". Ditën e shtunë presidenti konsideroi të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme për të parandaluar përsëritjen e protestave të dhunshme si dhe ka bërë thirrje për bashkëbisedim me protestuesit, tha zëdhënësi Benjamin Griveaux. Autoritetet u zunë në befasi nga përshkallëzimi në dhunë pas dy javë protesta në gjithë Francën kundër ngritjes së taksës së naftës.

rje për bashkëbisedim me protestuesit, tha zëdhënësi Benjamin Griveaux. Autoritetet u zunë në befasi nga përshkallëzimi në dhunë pas dy javë protesta në gjithë Francën kundër ngritjes së taksës së naftës.

SHKURT

SHBA, qeni shoqëron ish-presidentin në shërbimin e fundit

Nuk thonë kot që qeni është më besnik i njeriut. Dhe ky është Sully, qeni i ish-presidentit amerikan George Bush I, i cili nuk i është ndarë kurrë pronarit të tij, madje as tani pas vdekjes. Fotoja e cila ka prekur të gjithë ata që e kanë parë, është publikuar nga Jim McGrath, zëdhënësi i Bush, i cili publikoi fotografimin e qenit pranë arkivolit, me mbishkrimin, "Misioni i realizuar". "Sully" iu dhurua George Bush-it pas vdekjes së bashkëshortes së tij Barbara Bush, nga një organizatë jofitimprerëse, e cila u jep kafshë veteraneve të luftës. Duke mos e braktisur kurrë mikun e tij, Sully ka ende një mision, ta shoqërojë arkivolin e Bush në Uashington.

Britani/ Doli në dritaren e trenit, humb jetën 28-vjeçarja

Një e re ka vdekur tragjikisht në tren, pasi dyshohet kishte dalë në dritare kur u godit për vdekje në kokë. Policia britanike tha se 28-vjeçarja nga Penarth, identiteti i saktë i së cilës nuk bëhet i ditur, vdiq në vendngjarje teksa po udhëtonte me tren nga Bath për në Keynsham, ku do të merrte pjesë në ritualet në një tempull në Bristol. Ngjarja tragjike ka ndodhur mbrëmjen e së shtunës. Vdekja e të resë nuk është trajtuar si e dyshimtë dhe për këtë janë informuar edhe familjarët e saj. Hetimet megjithatë vazhdojnë.

Turqi, dy stinë të ndryshme në të njëjtën kohë

Të jetosh dy stinë të ndryshme në të njëjtën kohë. Kjo ka ndodhur këtë fillimdhjetori në Antalia të Turqisë, një destinacion i preferuar edhe për turistët shqiptarë. "Hurriyet" ka publikuar pamje në të cilat në njërin krah shfaqen turistët duke u hedhur në det, ndërsa në tjetrin shfaqen të rinj duke luajtur me topa bore në lartësinë 2 365 metra mbi nivelin e detit. Teksa në shumë zona të vendit temperaturat kanë rënë ndjeshëm duke mos munguar as reshjet e dëborës, në bregdetin e Kemerit temperaturat kanë shënuar 22 gradë celsius.

VEPRA HISTORIKE SIMPOZIUMI

Ferit Duka: I shërben albanologjisë. Mehdi Gurra: Inalcik, historian i kalibrit ndërkombëtar

"Qytetërimi osman" si sintezë shkencore

Ambasadori i Turqisë: Vepra, burim për punën e historianëve shqiptarë

Egla Xhemali

Ditën e djeshme në ambientet e hotel "Tirana" u mbajt një simpozium shkencor me temë "Qytetërimi osman". Simpoziumi u organizua nga Fondacioni "ALSAR", në bashkëpunim me YTB-në, Departamentin për Turqit që jetojnë jashtë atdheut dhe Marrëdhëniet me Komunitetet Mike. Arsyja e mbledhjes së këtij simpoziumi ishte botimi i veprës shkencore dyvëllimëshe "Qytetërimi osman". Pjesëmarrës ishin akademikë, intelektualë si dhe kërkues shkencor. E veçanta e aktivitetit kishte të bënte me faktin se trajtimi i qytetërimit osman u ndërthur me figurën e historianit të madh turk Halil Inalcik, për të cilin u mbajtën edhe katër kumtesa.

KREU I "ALSAR"

Fjalën e hapjes e mbajti Kryetari i Fondacionit "ALSAR", Zoti Mehdi Gurra që u ndal tek figura e historianit Inalcik.

"I ndarë nga kjo jetë vetëm pak më tepër se dy vite më parë, Halil Inalcik ishte një historian i kalibrit ndërkombëtar, mbajtës leksionesh në universitetet më të mëdha të botës. I njohur dhe si shejhi i historianëve apo si mësues i mësuesve, ai ka një kontribut të pasqor në fushën e studimeve osmane. Me reputacion të jashtëzakonshëm, Halil Inalcik-u ishte një studiues me dije të thella, me njohje të madhe të burimeve historike, një mjeshtër i analizës. Autor i shumë librave, ne kemi fatin t'ia çojmë cilësitë këtij historiani nëpërmjet botimit të "Qytetërimit osman".

Botimi i veprës "Qytetërimi osman" vjen si një përpjekje e Fondacionit "ALSAR" për të hedhur dritë mbi një perandori, pjesë e së cilës kanë qenë dhe shqiptarët.

Volumi i madh i materialit që në fillim u mendua si një veprë njëvëllimëshe në turqisht dhe anglisht, i bëri përgatitësit të kalonin në dy vëllime, ku i pari të përfshinte historinë dhe shkencën, ndërsa i dyti kulturën dhe artin. Vepra është e ndarë në nëntë kapituj, shkruar nga autorë të ndry-



shëm që vënë në pah kulturën e lartë osmane, pa haruar këtu dhe atë popullore. Në fillim të librit gjenden emrat e Halil Inalcik dhe të Günsel Renda-s, që kanë në faqet e para një parathënie të përbashkët. Günsel Renda është një historiane e njohur, autore dhe bashkëautore e shumë botimeve. Në

këtë veprë ajo i jep mjaft rëndësi artit osman nisur nga njohja që ka për këtë fushë.

DREJTORESHA E BIBLIOTEKES

Më pas në fjalën e saj për të pranishmit drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare prof. Persida Asllani u ndal tek vlerat e veprës duke çmuar



Simpoziumi shkencor me temë "Qytetërimi osman", dje në hotel Tirana

Botimi



MEHDI GURRA

Me reputacion të jashtëzakonshëm, Halil Inalcik-u ishte një studiues me dije të thella, me njohje të madhe të burimeve historike, një mjeshtër i analizës. Autor i shumë librave, ne kemi fatin t'ia çojmë cilësitë këtij historiani nëpërmjet botimit të "Qytetërimit osman".

PERSIDA ASLLANI

Metaforikisht drejtorja e Bibliotekës Kombëtare e përkufizoi punën e Halil Inalcik si një spektakël të qytetërimit osman në gjirin e qytetërimeve të tjera me të cilat u përplas dhe shkëmbu sistematikisht.



Drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare pohoi se ky autor është i njohur për studiuesit shqiptarë dhe se biblioteka disponon dhe tituj të tjerë veprash nga Inalcik.

turke, por edhe në atë botërore mbi historinë e një qytetërimi si ai osman. Metaforikisht Asllani e përkufizoi punën e Halil Inalcik si një spektakël të qytetërimit osman në gjirin e qytetërimeve të tjera me të cilat u përplas dhe shkëmbu sistematikisht.

Drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare pohoi se ky autor është i njohur për studiuesit shqiptarë dhe se biblioteka disponon dhe tituj të tjerë veprash nga Inalcik.

AMBASADORI I TURQISE

Më tej, ambasadori i Republikës së Turqisë në Shqipëri shprehu falënderime të thella për ata që mundësuan botimin e kësaj veprë që i përngjan një enciklopedie dijesh. Ai bëri një kalim të shkurtër në veprat e autorit Inalcik duke e vënë theksin tek "Qytetërimi osman". Sipas tij kjo veprë përveçse ka rëndësi për Turqinë është edhe një burim për gjithë punët e historianëve shqiptarë.

FJALA E HISTORIANIT

Një kumtesë të veprimitarive për punën e autorit Inalcik mbajti edhe prof. Ferit Duka. Ai çmoi punën e jashtëzakonshme të historiografit ndër vite. "Me zbulimin dhe hulumtimet e ngulta në defterin e sanxhakut shqiptar, por sidomos me botimin e tij, jo vetëm që u shëna pikënisja e historiografisë shkencore për periudhën osmane të Shqipërisë, por në të njëjtën kohë u përrua edhe fillimi i veprimtarisë studimore të Halil Inalcikut në shërbim të albanologjisë, investim madhor i këtij personaliteti në një terren shumë të vështirë siç ishte historia shqiptare e shek. XV qajtur ndryshe shekulli i madh i Skënderbeut". Profesori tha se autori na ka dhënë përmes një analize të fakteve dhe të dhënave të përfutur nga defterët osmanë të shek XV strukturën shoqërore të popullsisë shqiptare të kohës, dinamikën interesante brenda saj nën efektet e zhvillimeve dramatike me karakter politik dhe ekonomik. Përtej kësaj studimit e Inalcikut tha Duka hedhin dritë edhe mbi praninë e ngulimeve shqiptare në teritoritë të tjera të Gadishullit të Ballkanit, sidomos në Greqi. "Vepra e këtij dijetari të madh meriton të nderohet nga shqiptarët jo vetëm për vlerat shkencore të jashtëzakonshme që ajo mbart, por edhe për atë që e ka shpënë në të katër anët e globit emrin e tyre si popull dhe emrin e vendit të tyre Shqipërisë".

106-VJETORI I USHTRISË

Fatmira Nikolli

Letra lufte me italianë, gjermanë e komunistë

Thyeni prangat me të cilat ju kanë lidhur dhe luftoni për lirinë tuaj. Vëllëzër armësh, sabotoni fashizmin, bashkëpunoni me partizanët që luftojnë për lirinë e çdo populli.

Poshtë fashizmi dhe kusarët e Hitler e Musolini!

Rroftë Italia e lirë dhe liria e popujve!

Ushtri Mario Cristina".

Letra lufte e paslufte, si në një film bardhezi hedhin dritë mbi italianë, gjermanë e komunistë më shumë se 70 vite më parë. Njerëz që komandojnë, që luftojnë, që vrasin e vriten, gabime e fajë, emra të vdekurish që lanë eshtrat prej urdhrave që morën, të pajaf që u shuan për kapriçjo a méri të vogla. Nis më shumë se një shekull më parë historia e Ushtrisë Kombëtare. Me rastin e 106-vjetorit, këtë të martë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në bashkëpunim me Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura dhe nën kujdesin e Ministrisë së Mbrojtjes organizojnë sot në orën 11:00 në Muzeun e Forcave të Armatosura ekspozitën e përbashkët me dokumente dhe foto.

Në 4 dhjetor 1912, vetëm 6 ditë pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, u krijua Ushtria Kombëtare. Për herë të parë në historinë shekullore të vendit u krijua Ministria e Mbrojtjes Kombëtare, (Ministria e Luftës) e drejtuar nga Mehmet Dralla (Tetova) dhe Shtabi i Përgjithshëm i drejtuar nga major Ali Shefqet Shkupi. Strukturat kryesore përbërëse të saj ishin forcat aktive, rezervë ato vullnetare si edhe Xhandarmëria me 12000 personel gjithësej. Forcat e Armatosura u ndanë në Forca Tokësore, Forca Detare dhe Forca Ajrore.

NJË ITALIAN NË MALET E SHQIPËRISË: NGA LOTËT E KATUNDARËVE NJOHA BARBARIZMIN

"Bashkëpunoni me partizanët që luftojnë për lirinë e çdo populli"

Oficerë, Vëllëzër ARMËSH, POPULLI I ITALIS!

Ju flet nga malet e Shqipërisë një zemër e vërtetë italiane.

Nga mjerimet e mëdha të shkaktuara prej armatave të zeza, nga krimet e rënda të kryera në katunde në kurriz të popullatave të pafajshme, nga lotët e katundarëve, kam mundur të njoh palcën e barbarizmit fashist.

Provot e panumërta që fashizmi ju ka dhënë dhe do t'ju japë në qoftë se kjo luftë do të vazhdojë ende, varfëri që dita-ditës po shtohet, çkatërrimi i qyteteve t'ona, gjaku i vëllëzërve tanë që kërkon hakmarrje në çdo anë të botës, nuk ju dhanë të kuptoni se Musolini e ka shpurrë Italianë në çkatërrim dhe në dyshimin e pamvarësisë së sajë?

Italianë, Musolini në një nga fjalimet e tij ka thënë: "Do të vijë koha e bukur". Po, erdhi me të vërtetë dhe prandaj lufta sot ndodhet në portat e Italis. Musolini ju premtot begati dhe prandaj në çdo

anë të botës derdhet më kot gjaku i lules së djalëris italiane pranë buka jonë niset për në Gjermani në shkëmbim të materjalit për të vrrarë popujt. Musolini na ka premtuar liri dhe prandaj sot Italia është e okupuar nga armatat naziste, burgjet janë mbushur me njerëz të pafajshëm dhe populli italian është i lidhur me pranga nga skllavëria fashiste.

Nga të gjitha premtimet e bëra prej Musolini, ç'përfitim kemi pa-sur veçse të vjetër luftë, varfëri dhe çkatërrim?

Kjo tirani do të vazhdojë dhe do të shtohet gjithmonë më shumë në qoftë se fashizmi nuk dërmohet. Oficera të armatave të zeza, të kini trup dhe të mbani ment se lufta nuk fitohet me të çkatërruar fshtat të tëra; nderimi që i kini prurë popullit italian bie mbi ju dhe mbi krerët t'uaj.

Popull italian, kujtoni patriotët heroikë Garibaldi-n, Cavour-in, Mazzini-n; të jini të denjë të emrit që sillni, mos me joni që mallkimi i bijve t'anë të vjetër mbi neve, sot që armatat anglo-sovjet-amerikane marshojnë fit-

imtare në të gjitha frontet. Përfiton nga çastet për t'u bashkuar dhe për të marshuar kundër fashizmit. Thyeni prangat me të cilat ju kanë lidhur dhe luftoni për lirinë t'uaj. Vëllëzër armësh, sabotoni fashizmin, bashkëpunoni me partizanët që luftojnë për lirinë e çdo populli.

Poshtë fashizmi dhe kusarët e Hitler e Musolini!

Rroftë Italia e lirë dhe liria e popujve!

Ushtri Mario Cristina Regjiment i I-rë, i Xhenjos. Kamp. Deposito. Torino

1943, GJERMANËT: FURNIZOHEMI ME MATERIALE USHTARAKE NË PORTET SHQIPTARE

"Qeveria të na vejë në dispozicion magazina pa qira, të mos in-teresohet për llojin e furnizimeve"

Më 1943 gjermanët kishin lidhur marrëveshje me qeverinë shqiptare të kohës për t'u furnizim në portet shqiptare. Në 11 pika, marrëveshja ju vetëm që nuk ka gjurmë llogaridhënieje, por

merr komandën nëpër porte. "Ani-jet si duhet materiali, nuk i nënsh-trohen formaliteteve doganore shqiptare, mbasi shkarkimi i kapitenerisë se skelës dhe të zyrave gjermane të transportit. Qeveria shqiptare nuk intereso-het n'asnjë mënyrë për llojin dhe sasin e materialit të furnizimeve të ushtrisë gjermane", thuhet mes të tjerash.

DOKUMENTI

Adhutanti Ushtarak i Plotëfu-qishëm të veçantë Gjerman Shkurtri furnizim detar në liane të Shqipërisë Minsitris së Jashtme Shqiptare Tiranë 22.Nandu.1943

Kemi nderin me ju njoftue mbi sa vijon.

Ndërmjet përfaqësuesve të marinës luftarake gjermane asht arritun marrëveshje si vijon këtu poshtë.

1)Marina Luftarake Gjermane importon me anije tregtare materiala material furnizimesh ushtarake të çdo lloji nëpër skelët e ndryshme të Shqipnis. Anijet si duhet materia-li, nuk i nënshtrohen formaliteteve doganore shqiptare, mbasi shkarkimi i kapitenerisë se skelës dhe të zyrave gjermane të transportit. Qeveria shqiptare nuk intereso-het n'asnjë mënyrë për llojin dhe sasin e materialit të furnizimeve të ushtrisë gjermane".

transportit. Qeveria shqiptare nuk intereso-het n'asnjë mënyrë për llojin dhe sasin e materialit të furnizimeve të ushtrisë gjermane.



2)Skela të nevojshme për furni-zimet ushtarake janë: Vlona, Dur-rësi, Shëngjini, Buna me liqenin e Shkodrës dhe Ulqini.

3)Marina ushtarake gjermane zbaton kontrollimin e dokumente-ve në skelat e lartpërmendura për të gjitha personat, të çdo nacionaliteti qofshin (edhe ushtar-akë gjermanë) simbas mostrës së përfolun me Major Bumcin.

4)Në skelën e Durrësit qeveria shqiptare do të vejë në dispozicion të Marinës Luftarake Gjermane pa qira dy magazina (në vendqënd-rimet nr.1 e 2 me një përmbajtje prej afro 1000 xxx) për kohën që do të qëndrojnë ushtrit gjermane në Shqipni. Magazinat dhe bar-akat që i përkishtin ish ushtrisë italiane nuk preken mbi sa më nalt.

5)Të gjithë nëpunist që ndodhen në anijet si edhe në tokë të skelës së Durrësit e që janë pasuni ita-liane janë sekuestrue prej marinës luftarake gjermane. Lirim i kësaj pasunije bahet prej koman-dës Gjermane të skelës sipas urdhënit që do t'i jepet.

6)Mjetet ushqimore që ndod-hen në skelë e që janë pasuni sh-





qiptare janë rë lira dhe mund të ngrihen me një herë.

7) Fuqi ushtarake e sidomos marina luftarake gjermane marin përsipër rojen në sinurin e skelës. Nuk merr për sipër asnjë përgjegjësi për vjedhjen sidomos për ato që kryhen natën.

8) Marina ushtarake gjermane nuk ka ndonji kundërshtim që pa-sunija në sinurin e skelës të ruhet prej shqiptarësh t'uniformuem. Vetëm se në vendosjen e fuqive ndihmuese shqiptare në sinurin e skel-

ës asht nevoja qi ma parë të bise-dohet me komandantin gjerman të skelës.

9) Komandanti Italian i skelës do të qëndrojë tash si civil në vendin e tij, si kapiten i skelës. Me ardhjen e një drejtuesi gjermane të transportit detar shngarkohet kapiteni italian. Marina luftarake gjermane merr përsipër të kryemit e veprimet vetë të tij deri në vendosjen e një kapiteni shqiptar...

10) Anijat shqiptare që ndodhen për tash në limanet e Shqip-

nis nuk mund të dalin prej limanesh deri në skjarimin e përfunduem të gjendjes detare, për daljen e anijevet jashtë limanet japin zyrat e marinës... me udhnat përkatës.

11) Në rast se marina luftarake gjermane nevojit anijën shqiptare do të hyjnë vetë në marrëveshje me pronarët për marrjen e tyre me qira. Lutemi që të vërtetosh edhe zyrtarisht këta vendime.

Me çftaje nderimi të veçantë Kapiten Lange.

Shehu, letër familjes së Ramize Gjebreas: Ekzekutimi i vajzës suaj, i pavend

"Gjykata e Lartë konstatoi se vendimi i marun kundrejt shoqes Ramize nga ana e gjyqit të Brigadës V ka qenë i ekzaxheruar"


Me ikjen e pushtesve, tan imë qenë shqiptarët që 'po lanin hesapet' me njëri-tjetrin. Në rastin e letër në vijim bëhet fjalë për një sqarim për një jetë të humbur - i jepej pafajësia pas vdekjes, por pa u kërkuar falje për jetën e humbur. Bëhet fjalë për Ramize Gjebrenë, për të cilën në një letër drejtuar familjes Mehmet Shehu shprehet ngushëllimet, pranonte ekzekutimin e saj të gabuar pas një gjyqi që e ka ekzagjeruar. Letra është e 18 janarit 1947 dhe mban vulat e Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, Sekretariatit i Shefit të Shtatmadhorisë.

Familjes së dëshores Ramize Gjebrea

Gjykata e Lartë e Komandës së Përgjithshme, në këto kohët e fundit mori në rishqyrtim dënimin e dhënë vajzës t'uaj Ramize, n'operacionin e dimrit 1943-944 nga ana e Gjyqit të Brigadës V-të.

Nga ky rishqyrtim u konstatua se nga rrethanat në të cilat u dha dhe u ekzekutua vendimi mbi vajzën t'uaj Ramize kanë qenë të vështira për Lëvizjen t'onë N.Ç.L duke marrë parasysh propagandën që bënte okupatori dhe Balli Kombëtar kundrejt nesh e sidomos kundrejt moralit t'onë partizan.

Me gjith'atë Gjykata e Lartë konstatoi se vendimi i marun kundrejt shoqes Ramize nga ana e Gjyqit të Brigadës V-të ka qenë i ekzaxheruar. Për konseguencë Gjykata e Lartë e konsideron ekzekutimin e vajzës t'uaj të pavend dhe shoqja Ramize konsiderohet njësoj sikurse të gjitha shoqet e tjera që ranë



dëshmore për çlirimin e Atdheut kundër okupatorit dhe tradhtarëve të vendit.

Ju duhet të jeni kryelartë për bijën t'uaj Ramizenë e cila as një herë nuk u kursye për të derdhur të gjithë aktivitetin e saj në të mirën e Atdheut dhe të popullit.

Sado me vonesë, lutemi pranoi ngushëllimet t'ona
KRYETARI SHTATMADHORIS
General Major
(Mehmet Shehu)
Firma

Kokëqethura, nën tehun e gjyqinës

Luan Rama*

Kokëqethura nën tehun e gjyqinës. Viti 1944-1945. Kjo ndodhi në Francë. Kohë më parë kjo kishte ndodhur dhe në Spanjë, në Gjermani, nëpër botë... Lufta sapo kishte mbaruar dhe koka grash qetheshin përmes forcës. Kokëqethurat shtyeshin si bagëti dhe zvarriteshin në sheshet publike, nën thirrjet historike të turmës të dehur nga urretja dhe fitorja. Ishin trofetë e fitores, poshtërim, tjetërsimit, ato që shkuan me pushtuesin... Ato!

Të dashurosh armikun në kohë lufte ndëshkohesh rëndë. Heroina e "Hiroshima mon amour" (Hiroshima dashuria ime) e Marguerite Duras dashuroi një ushtar gjerman në fundin e luftës dhe kokëqethur u mbajt në një bodrum të shtëpisë, në botën e errësirës. Pauline Dubisson, një tjetër vajzë, dhe mijra të tjera si ajo, përjetuan tragjedinë e kohëve modern: 20 mijë koka të

qethura brenda disa ditësh. Flokët dalin sërrish por shpirtat e vrarë do të jetojnë letargjinë e pafund të poshtërimit. Përse vetëm gratë qethen, poshtërohen, përdhunohen? Pauline Dubisson (Polinë Dwybyson) të cilës autori i ka kushtuar këtë roman biografik, ka guxuar të ngrihet kundër atij linçimi, si reagim ndaj asaj që i bëri shoqëria në veri të Francës pas luftës së dytë botërore, fill pas çlirimit ku një "gjueti shtrigash" u ndërmor kundër atyre femrave që kishin shkuar me gjermanët pushtues apo i kishin dashuruar (të mos harrojmë këtu dhe aktoren Arlety apo të famshmen Edith Piaff, etj.) Eshhtë një histori analoge me atë që kemi parë në filmin e Alain Resnais me skenar të shkruartares së njohur Marguerite Duras, "Hiroshima, dashuria ime" ku protagonistja, një vajzë e re në thellësi të Francës, në Nevers, në ditën e fundit të luftës, e kishin lënë me ushtarin gjerman të takoheshin dhe të iknin bashkë drejt Gjermanisë. Por kur ajo shkoi në vendin e takimit e gjeti atë të sapo vrarë. Atëherë dhe asaj vajze i qethën flokët në ditët e para të çlirimit. Një qethje në sheshin publik, ashtu siç u qethën mijra të tjera nëpër gjithë Francën brenda disa ditëve. Një spektakël i tmerrshëm për ato që e pësuan dhe ata që e bënë, pasi ata "burra të nderit" duhet ta kenë ndjerë fajin e madh në shkatërrimin e shumë jetëve të pambrojtura. Ky spektakël i mijra kokave të qethura në sheshet publike, në rrugë, nën brohorimat e turmës, në podiume provizore, mbetën stigmate që u ngjizën në shpirtat dhe jetët e

atyre vajzave. Ishte nga shprehet më të mëdha të intolerancës dhe dhunës mashkullore ndaj graas. Ishte një "bombë" si ato të Hiroshimës që ra në shpirtat e tyre duke lënë plagë të hapura e përvëluese apo duke i çuar ato drejt vetvrasjes. Imazhe që menjëherë të çonin në vergun klithës poetik:

Kokëqethura, nën tehun e gjyqinës

Zgjidh i thanë: përdhunimin ose jetën, por me rrobzet e shqyera dhe lakuriqësinë e trupit ajo jetonte në një botë tjetër, ç'po ndodh kështu Zoti im? Vallë i kanë harruar motrat e tyre?... Ishte dita e kalvarit, pasluta,



një orë, dy, pesë, turma shfrynte mbi trupin e saj si një buldozer i hekurit që i thyente kokat kofshët, gjoksin, vaginën dhe gojën me erën e gjakut dhe të spermës mbi plagët mavi.

Më së fundi ajo ofshau, i kishte klithur qielli që ra përmbys,

tokës që u hap greminë, botës në zinë e madhe, ulëriu si të ishte dhe ajo një bishë, një Ceber në rrathët e ferrit, një bishë më shumë se bisha.

Egërsira u zgjua dhe ata ikën me vrap si ti ndiqte demoni, pastaj ra heshtje, vetëm dihaste, plagët blu pikonin gjysmë-gjallë, gjysmë-vdekur; qante në heshtje nën dritën e një hëne të vrarë, qante mbi tetëmbëdhjetë vjetët e saj, dhe lulet fillikate që ranë, qante mbi qumështin dhe frymën. Ishte fill pas lufte, 1944-1945, kur mijra vajza e gra i qethnin në sheshet e harbuara të urretjes pse kishin shkuar me pushtuesin, mijra koka tullace parakalonin në rrugë

dhe në skenat publike, i tërhiqnin zvarrë nën brohorima, duke përdhunuar kështu trofetë e një lufte, trofetë e fitores, pa ditur se përdhunonin zemra dhe thyenin mijra jetë, një luftë mbaronte dhe një tjetër do të fillonte mbi tokat e shketruara, mbi hirin dhe lulet që dignin duke pritur erën e ngrohtë dhe kushidhi siun e një dashurie të re...

Opinion *i* Ditës

Ajo që mbështetësit e Ramës për Unazën nuk guxojnë ta thonë

Nga Andi Bushati

(vijen nga faqja 1)

... e Re. Të gjithë, gazetarë, analistë dhe media pranë pushtetit janë të gatshëm të flasin për gjithçka: për moralitetin e zaptuesve të vendosur dy dekada më parë në Tiranë, për teorinë e zhvillimit të qytetit, për interesat e Lulzim Bashës në këtë çështje, për burrat e munguar të policisë së plagosur Ina dhe për mënyrën se si ka proceduar qeveria "Berisha" në raste të ngjashme.

Njësoj si në debatin për teatrin, kur nuk nguronin të diskutonin nëse duhet përkrahur risia apo mbrojtur tradita, ka të drejtë Asgriu apo Ndrenika, është duke u shembur apo mund të rezistojë godina, shkakton apo jo kancer: po njësoj edhe tani, të gjithë mbrojtësit mediaticë të qeverisë se kanë me droje përballjen.

Por vetëm për një gjë askush nuk guxon të shprehet.

Kam lexuar me dhjetëra shkrime, kam qëmtuar me qindra qëndrime në debatet televizive, por kam vërejtur me çudi që të gjithë fshihen përballë pyetjes: ka apo nuk ka vjedhje?

Askush, po askush deri më tani,



edhe avokatët më fanatikë edhe ata që paguhen legalisht nga bordet e qeverisë, edhe ata që ushqehen në mënyrë okulte prej saj, nuk ka dalë e t'u vërë gjoksën "duarve të pas-tra" të atyre që qëndrojnë pas këtij projekti.

Grupi i gatshëm që mbështet dyshen Veliq-Rama me çdo lloj cirku dhe që denigron me po të njëjtin zell, trinomin Berisha-Basha-

Kryemadhi, i anashkallon disa pyetje të thjeshta...

Si ka mundësi të paguhen 40 milionë euro për 2.2 kilometra?

Po, mirë, pavarësisht se kjo s'ndodh në asnjë vend normal të botës, le ta pranojmë se po ngjan këtu. Le ta pranojmë edhe se këto kosto qenkan reale. Po si ka mundësi që për këto 40 milionë, projekti është dhuruar gratis?

Si ka mundësi që "donatori" genkësh porositur prej njëres prej firmave që më pas ka rezultuar fituese?

Si ka mundësi që nuk u kërkua një projekt alternativ, që ndoshta parashikonte një kosto më të ulët?

Si ka mundësi që krejt papritmas, kundër planeve dhe projekteve të miratuara, gjerësia e rrugës u rrit ndjeshëm? Mos vallë se ko-

mpanive ndërtoese u duheshin më shumë para?

Si ka mundësi që nuk u zhvillua një garë reale për të ndarë 40 milionë euro, por në të tria tenderimet u paraqit një kompani false me ofertë zero, si vëllezërit Hysa?

Si ka mundësi që u mbyllën sytë për subjekte, të cilat ligji shqiptar i pengon të hyjnë në garë dhe si u shpallën fituese kompani të regjistruara në parajsat fiskale?

I gjithë ky enumeracion pyetjesh i shton shumë dyshimet se tek Unaza e Re nuk kemi të bëjmë me një aferë të pastër dhe të ndershme.

Prandaj, tërë ata që duan ta mbrojnë qeverinë janë të gatshëm të flasin për gjithçka, vetëm kësaj nolle nuk i vënë dot gjoksën. Lexojini shkrimet e tyre, vëzhgojini paraqitjet e tyre në TV, analizojini kronikat që bëjnë dhe do të kuptoni se kush refuzon të shprehet për këto pyetje (qoftë edhe duke mbrojtur qeverinë) është duke ju gënjyer.

Është fiks njësoj si me historinë e Teatrit Kombëtar, që kush hiqej si ithtar i Tiranës moderne, si dashnor i famës së Bjarke Ingels, si kundërshtar i trashëgimisë fashiste, nuk qe asgjë më shumë sesa gardist i zellshëm i grabitësve Rama-Fusha.

THASHETHEME MADE IN ALBANIA

BLUE TOOTH

THASHETHEME MADE IN ALBANIA

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

çdo të shtunë falas me GAZETA SHQIPTARE

Analiza e Ditës

Qeveria, shpronësime në bregdet për llogari të investitorëve "strategjikë"

Nga Gjergj Erebara

(vijon nga faqja 1)

... duke refuzuar regjistrimin e pronësive së tyre në të gjitha rastet kur parcelat e tokave "janë zënë nga ndërtimet pa leje", ose janë zënë nga të ashtuquajturit "investitorë strategjikë".

Projektligji "Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësive në Republikën e Shqipërisë", në nenin 10, pika 2, parashikon që toka bujqësore e shpërndarë më parë dhe për të cilën, fshatarët kanë aplikuar për ta regjistruar nën pronësi, duhet të plotësojë disa kushte, mes të cilave, kjo tokë "nuk duhet të jetë e zënë nga ndërtimet pa leje" si dhe "nuk duhet të jetë objekt i investimeve strategjike".

Projektligji në fjalë parashikon gjithashtu që ndërtimet pa leje, pavarësisht se ku gjenden, të mund të blejnë tokën kur atë ia kanë grabitur të tjerëve (situatë e rëndomtë kjo në bregdetin shqiptar) si dhe të paguajnë çmimet e hartës së qeverisë "Rama", çmime shumë të debatuar që janë disa dhjetëra herë më të ulëta se sa çmimet e tregut.

"Tokë që kalohet në pronësi, pa shpërblim, duhet të përmbushë njëkohësisht, këto kushte", shkruhet në ligj.

"Të mos jetë zënë nga ndërtimet pa leje, të të tretëve apo të vetë subjektit kërkues" dhe "Të mos jetë objekt i investimeve strategjike, sipas ligjit nr.55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë".

Qeveria shqiptare miratoi një vendim kontrovers të Këshillit të Ministrave në mars 2018, në bazë të së cilit, të gjitha aktet e marrjes së tokës në pronësi të mos regjistruar në Zyrat e Regjistrimit të Pronave të Patundshme në rast se toka në fjalë gjendet në zonën bregdetare të Shqipërisë.

Pezullimi i argumentuar në atë kohë si i përkohshëm dhe që u hiqte banorëve të zonave bregdetare një të drejtë të fituar me ligj synonte të krijonte atë që qeveria e quan "fond mbështetës për investimet strategjike".

Projektligji i ri duket se synon ta kthejë këtë masë "të përkohshme" në anulim të përhershëm të të gjitha tokave bujqësore në zonën bregdetare, të cilat u prishin punë atyre që qeveria i cilëson si "investitorë strategjikë".

Projektligji aktual thotë se në të gjitha rastet kur toka i takon ende përfutës të AMTP-së (akronim për Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi), por nuk plotëson kushtet e qeverisë "Rama" për të qenë nën pronësi, atëherë ajo shpronësohet brenda 30 ditësh dhe bëhet pronë shtetërore. (Pika b e nenit 8 të projektligjit të propozuar).



"INVESTITORËT STRATEGJIKË"

Qeveria "Rama" ka miratuar një masterplan për zonën e jugut të Shqipërisë, si dhe ka në proces miratimin e masterplaneve për zona të tjera bregdetare, ku parcela të mëdha toke janë ndarë më vete të shënuara si "investime strategjike".

Investigime të mëparshme të BIRN kanë zbuluar se si disa nga këto investime strategjike janë duke u ndërtuar aktualisht në toka të kontestuar.

Lista e kompanive që kanë përfutur statusin e investitorëve strategjikë përfshin aktualisht tetë kompani. Statusi jepet nga një institucion i quajtur Komiteti i Investimeve Strategjike. Në listën e tokave të dhëna me këtë ligj janë parcela në Gjirin e Lalzit si dhe në Dhërmi e në Sarandë.

LEGALIZIM PËR ZAPTUESIT

Në një kapitull tjetër të ligjit hapet rruga për një valë të re legalizimi të ndërtimeve pa leje, por edhe këtu, "investimet strategjike" rezultojnë shpëtimsi kryesor i qeverisë. Sipas projektligjit, të gjitha ndërtimet pa leje që gjenden në "ter-

ritore të destinuar për investime strategjike" nuk legalizohen. Po i njëjti kapitull mundëson legalizimin e ndërtesave që janë bërë në tokë të zaptuar, për të cilat ndërtuesi nuk ka titull pronësie. Të tilla trajtohen si ndërtesat "për qëllim banimi", ashtu edhe ndërtesat të cilave qeveria u referohet si objekte me "funksion social-ekonomik". Edhe në këtë rast, çmimi i blerjes së tokës nga ndërtuesi zaptues bazohet në vlerën referencë të hartës së tokës, çmime të miratuara nga qeveria "Rama" dhe që janë disa dhjetëra herë më të ulëta se sa çmimet e tregut.

"Çmimi i shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje, me funksion banimi dhe të përzier (social-ekonomik dhe banimi) është çmim favorizues, ndërsa për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik, është ai i përcaktuar në hartën e vlerës së pronës për llojin e pasurisë "truall", shkruhet në ligj.

Qeveria "Berisha" nisi praktikën e përcaktimit të çmimit referencë me vlerë shumë herë më të ulët se sa tregu, si pjesë e përpjekjeve për të kompensuar pr-

Qeveria shqiptare miratoi një vendim kontrovers të Këshillit të Ministrave në mars 2018, në bazë të së cilit, të gjitha aktet e marrjes së tokës në pronësi të mos regjistruar në Zyrat e Regjistrimit të Pronave të Patundshme në rast se toka në fjalë gjendet në zonën bregdetare të Shqipërisë.

onat e zëna gjatë kohës së regjimit komunist. Në një seri vendimesh pasi erdhi në pushtet, qeveria "Rama" miratoi çmime edhe më të ulëta se sa ato të qeverisë "Berisha". Ndërsa mbetet e debatueshme nëse pronat e konfiskuara apo transformuara gjatë kohës së komunizmit mundet apo jo të kompensohen me çmim më të ulët se sa tregu, mbetet e paqartë arsyeja se pse qeveria e sotme pranon të përdorë të njëjtat çmime për të mundësuar blerjen e tokave të zëna nga zaptues, kur këta e përdorin tokën e zaptuar "me funksion social-ekonomik".

Është e paqartë se si do të përcaktohet se cili është çmimi i tokës "truall" i përdorur në rastet kur toka e zaptuar është në zonat bregdetare. Në çmimet referencë të fshatrave të bregdetit të jugut, p.sh., nuk ka referencë për "tokë truall", ndërsa çmimet e tokave bujqësore variojnë nga 88 në 204 lekë për metër katror. Ky është çmimi më të cilin do të kompensohet teorisht pronari i tokës, të cilin ia kanë marrë tokën në kohën e komunizmit. Por, duket se ky është çmimi që qeveria ka ndër mend të pranojë nga zaptuesit dhe ndërtuesit pa leje, si çmim për blerjen e tokës së zaptuar. Gjithashtu, për tokat e zëna në zonën përreth Tiranës, çmimi referencë varion nga 500 në 2,500 lekë për metër katror.

Qeveria ka parashikuar në projektligj të kthejë edhe një herë të ashtuquajturat "Bono Privatizimi". Sipas pikës 9 të nenit 19, pagesa për tokën e zaptuar mund të bëhet në lekë, ose në bono privatizimi.

Reporter.al

HOROSKOPI

DASHI

Do të kaloni një ditë të vështirë në punë, megjithatë do të përfundoni gjithçka nëse nuk shpërqendrohni nga çështje të tjera. Mos dëgjoni bisedat e të tjerëve dhe refuzoni me takt të ndihmoni dikë, i cili iu afrohet vetëm për interes.

DEMI

Sot mund t'ju kthehet një çështje, të cilën e keni lënë pas dore. Ka të bëjë me pasuri të patundshme. Në fushën e ndjenjave, sot nuk ju rekomandohet që të ndërmerrni hapa të rëndësishëm. Lërimi gjërat të rrjedhin vetë.

BINJAKET

Do të ishte mirë që sot të mos përfshiheshit në blerje. Nëse keni ndërmend të bëni ndonjë marrëveshje, ka gjasa që të mos merrni rezultat in duhur. Keni nevojë për ndryshime në aspektin profesional.

GAFORJA

Do të mendoni rreth disa ideve të ndryshme, por mund të mos arrini rezultat në asnjë prej tyre. Në mënyrë që ta parandaloni një gjë të tillë, zgjidhni prioritetin kryesor dhe përqendrohuni tek ai. Shmangni personat egoistë.

LUANI

Disa persona të shenjë së Luanit mund të jenë afër arritjes së ëndrrës së tyre. Ndosh-ka ka të bëjë me karrierën ose me suksesin në biznes. Disa persona të tjerë të kësaj shenje ka gjasë të bëjnë disa ndryshime të rëndësishme në jetën e tyre personale.

VIRGJERESHA

Këtë të martë do t'ju përfshijë rutina dhe nuk do t'ju premtojë koha për të organizuar diçka në mbërmje për t'u argëtuar. Megjithatë, do të mendoni rreth mënyrave sesi mund të shënoni rezultate në fusha të rëndësishme si karriera, biznesi apo dashuria.

PESHORJA

Mos i nënvlerësoni këshillat e shokut/shoqes tuaj të ngushtë, pasi në bazë të tyre mund të zgjidhni disa probleme shumë të rëndësishme. Ka gjasa të takoheni me një person, i cili do të mbështesë idetë tuaja.

AKREPI

Duhet të gjeni një burim tjetër të ardhurash. Mund të nisni një aspekt të ri të jetës suaj, por për këtë do të hiqni dorë nga shumë gjëra. Nuk keni shumë kohë të mendoheni dhe duhet të veproni sa më shpejt të jetë e mundur.

SHIGJETARI

Mund të merrni një dhuratë anonime. Ka gjasa që të jeni në vëmendjen e dikujt, çfarë do t'ju befasojë tërësisht. Gjithashtu, surprizat do të vazhdojnë edhe gjatë pasdites, pasi do të mësoni një lajm shumë të rëndësishëm.

BRICJAPI

Do të përballeni me një problem, të cilin do arrini ta zgjidhni vetëm me ndihmën e familjes suaj. Do të kaloni momente të mrekullueshme me partnerin/partneren tuaj, madje do të përjetoni romancën e vërtetë.

UJORI

Do të jeni të heshtur dhe nuk do t'i shprehni mendimet tuaja. Mos ndërmerrni hapat të rëndësishëm kur nuk ndiheni të sigurt. Do të kaloni në mbërmjetë këndshme nën praninë e familjarëve tuaj, të cilët janë ankar vazhdimisht kohë e fundit për më shumë vëmendje nga ana juaj.

PESHQIT

Për disa persona të kësaj shenje, detyra më e vështirë për ditën e sotme do të jetë pajtimi me një familjarin tuaj. Bëni kujdes me fjalët, pasi mund të ofendoni personat rreth jush. Do të ishte mirë që sot të mos përfshiheshit në çështje financiare, planifikime apo nënshkrim marrëveshjesh.



UEFA vendos për teknologjinë në gjykim

Zyrtare, në shkurt futet VAR-i në Champions League

Dje në Dublin ka pasur zhvillime të reja, por këtë radhë jo në lidhje me shortin e Europianit, por për Ligën e Kampionëve dhe mundësinë e përdorimit të sistemit VAR. Kështu, UEFA ka vendosur që të miratojë përdorimin e

këtij sistemi, që nga ky sezon duke nisur nga faza tjetër e eliminimit direkt. Komiteti ekzekutiv i mbledhur dje në Dublin, ka vendosur që të aprovojë përdorimin e VAR-it duke nisur nga muaji shkurt 2019 dhe do të përdoret në

fazën e 1/16-ave e mbrapa. Në fillim, mendohej nga sezoni tjetër, por duke parë gabimet e shumta e sidomos atë të Kasait në ndeshjen Manchester Siti-Shakhtar, u vendos që të përshpejtohej procedura. Vetë presidenti i

UEFA-s, Aleksandër Ceferin ka folur për mediat pas vendimit të marrë dhe ka pranuar se përveç Ligës së Kampionëve, do të ketë një përdorim më të gjerë të këtij sistemi. "Ne jemi të gatshëm të përdorim VAR-in më herët sesa që ishte planifikuar fillimisht dhe jemi të bindur se do të jetë e dobishme për garat tona, pasi do të ofrojë ndihmë për gjyqtarët dhe do të zvogëlojë vendimet e gabuara", u shpreh Ceferin.

Hodhi banen ndaj Obamejangut, Totenhami përjashton përgjithnjë tifozin

Arsenali imposhtoi Totenhamin me rezultatin 4-2 në derbin e Londrës, të zhvilluar në "Emirates Stadium", por pasditja nuk shkoi aspak mirë për një nga fansat e skuadrës së Poketitinos. Ai provokoi duke hedhur një lëkurë bananeje drejt sulmuesit të "topçinjve", Pierr Emenik Obamejang, teksa ky i fundit po festonte golin e Hugo Loris. Por forcat e sigurisë e identifikuan menjëherë nëpërmjet kamerave, e morën nga shkallët e stadiumit dhe e vunë nën masën e arrestit tifozin, që tani do të përballlet me pasojat e gjestit aspak të hijshëm të tij. Ndërkohë gjatë ditës së djeshme ka reaguuar edhe klubi i Totenhamit, që ka marrë vendim të përjashtojë përgjithnjë tifozin, nga shkallët e "emblem"-tani dhe të stadiumit të ri që po ndërtohet për "Spurs"-at. Kjo është një tjetër shenjë se në Angli e kanë seriozisht luftën kundër racizmit, ndërsa tani tifozë të tjerë duhet të mendohen gjatë, para se të bëjnë gënjatje të tilla nga shkallët e stadiumit.

Është i pari kroat në histori që fiton këtë çmim. Mbape fitues për të rinjtë, Hegerberg për femra



Jeton Selimi

Luka Modriç fiton "Topin e Artë" 2018

Ashtu siç pritej, mesfushori la pas Ronaldon

Kapiteni i Kroacisë nënkampione bote dhe ylli i mesfushës së Realit të Madridit, kampion Europe, Luka Modriç është fituesi i "Topit të Artë" 2018. Mesfushori bëhet kroat i parë në histori që arrin të fitojë trofeun më prestigjioz individual dhe e bën këtë duke thyer një hegjemoni 10-vjeçare të dyshes Mesir-Ronaldo.

"Është një ëndërr e realizuar për mua dhe falënderoj të gjithë trajnerët e mi, shokët e skuadrës, klubin e Realit të Madridit dhe të gjithë të përfaqësuesja kroate, por mbi të gjitha familjen time. Të gjithë kemi ëndërra të fitojmë trofe të rëndësishëm dhe Topi i Artë ishte më shumë se një ëndërr, ndaj jam vërtetë i nderuar që marr këtë trofe", deklaroi Modriç gjatë marrjes së çmimit.

Luka Modriç udhëhoqi Kroacinë në botërorin



"TOPI I ARTË"

RENDITJA

- 1 - Luka Modriç (Kroaci, Real Madrid)
- 2 - Kristiano Ronaldo (Portugali, Juventus)
- 3 - Antuan Grizman (Francë, Atletiko Madrid)
- 4 - Kilian Mbape (Francë, PSG)
- 5 - Lionel Mesi (Argjentinë, Barcelona)
- 6 - Mohamed Salah (Egjypt, Liverpool)
- 7 - Rafael Varane (Francë, Real Madrid)
- 8 - Eden Hazard (Belgjikë, Çelsi)
- 9 - Kevin De Bryjn (Belgjikë, Mançester Siti)
- 10 - Herri Kejn (Angli, Totenhem)

"Rusi 2018", duke e çuar në vendin e dytë, ndërsa ishte një nga liderët e Realit të Madridit, që arriti të fitojë 3 herë radhazi Ligën e Kampionëve.

Ylli kroat arriti të marrë 753 pikë, i ndjekur nga Kristiano Ronaldo me 476 dhe Antuan Grizman me 414 pikë.

Kilian Mbape është shpallur fituesi i parë i trofeut "Kopa" që do të jepet çdo vit përkrah "Topit të Artë" për futbollistin e ri më të mirë nën 21-vjeç. Veçoria e këtij trofeu është se fituesi zgjidhet nga votimi i ish-fituesve të "Topit të Artë" në edicionet e kaluara. "Është një nder i madh të jem këtu mes jush, mes profes-

azheve të botës së futbollit. Ishte një nder i madh të jem mes jush, në botën e futbollit. Përsëritës familjen time dhe shumë njerëz që nuk njoh këtu në sallë, por jam i lumtur që tregoj këtë trofe para jush. A është objektiviteti i vitit të ardhshëm të fitoj përsëri këtë trofe dhe "Topin e Artë"? Jo, objektiviteti im është të fitoj çdo trofe, jo vetëm këtë", tha duke qeshur sulmuesi pasi mori çmimin që jepej për herë të parë këtë vit. Fituesja e çmimit të "Topit të Artë për Femra" është Ada Hegerberg, sulmuesja e Olimpikut të Lionit në Francë. Kjo është hera e parë që jepet një "Top i Artë" për femrat.

SUPERLIGA

Duhej të luhej në orën 18:00, pasi një nga sfidat më të forta të javës së 16-të meriton padyshim vëmendjen më të madhe në këtë fundjavë së bashku me Teuta-Partizani. Dy sfida që lidhen direkt me fatet e kreut dhe që pritet të dhurojnë emocione të shumta. Por nëse Teuta-Partizani i kanë hallet e zgjidhura, ndryshon puna për Kukësi-Skënderbeu. Veriindorët kanë pasur probleme të shumta në këtë sezon për të gjetur një stadium, duke qenë se "Zeqir Ymeri" ngeli në klasë nga Komisioni i Licensimit. Por gjithsesi, nënkampionët kanë njoftuar se përballjen e rëndësishme do ta zhvillojnë në stadiumin e Kamzës, ditën e premte në

Zyrtare, Kukësi-Skënderbeu luhet të premten në Kamzë




orën 14:00, ndryshe nga sa ishte parashikuar nga federata, që këtë sfidë të rëndësishme e kishte caktuar në orën 18:00. Por fusha e Kamzës do të jetë e rënduar këtë javë, duke qenë se të dielën do të zhvillojë ndeshjen e saj Kamza, që pret në shtëpi Luftëtarin.

SUPERLIGA		
JAVA E 16-të		
TË PREMTEN		
Kukësi - Skënderbeu	14:00	
TË SHUTUNEN		
Tirana - Kastrioti	14:00	
Teuta - Partizani	17:00	
TË DIELEN		
Kamza - Luftëtari	14:00	
Flamurtari - Laçi	17:00	
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Partizani	15	34
Skënderbeu	15	30
Teuta	15	28
Kukësi	15	27
Laçi	15	26
Flamurtari	15	22
Luftëtari	15	13
Tirana	15	11

Shefi i arbitrave flet për gafën në Roma-Inter

Niki: Penalltia e padhënë Romës, gjest i pashpjegueshëm




mentojë episodin e mbrëmshëm, por edhe ky nuk ka arritur të shpjegojë mung-

esën e përdorimit të VAR-it. "Nuk kam asgjë për të thënë, përveç se të pranoj se kemi të bëjmë me një gabim të pashpjegueshëm. Me këtë rast duhet të merret dizenjatori i arbitrave dhe të marrë masa, pasi është e patolerueshme, që edhe pas atyre pamjeve, VAR të mos reagojë", deklaroi Niki.

Mediat italiane raportojnë se edhe dizenjatori i arbitrave, Nikola Ricoli do të merret me rastin dhe pasi të kuptojë se kush gaboi, do të ndërhyjë për ta pezulluar me disa javë, pasi edhe me VAR, arbitrat italianë vijnë të gabojnë shumë.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Hari spiune.
4. Janë toksike.
9. Gjysmë arrest.
10. Janë vende pa ne.
13. Johnny i Donnie Brasco.
15. Priten nga meridianë.
18. Me të nxjerrin një letër.
20. U verbua nga Askushi.
21. Një britmë në arenë.
22. Shkrimtari i J'accuse.
24. Si moral.
25. Nota e diapazonit.
26. Me dies në një liturgji.
27. Një mund të jetë edhe veprimi.
28. Eshhtë e re pas Krishtit.
29. Inicialet e Bergman aktore.
30. Ai i trëndafilut është i Umberto Eco-s.
32. Fise pa fe.

33. Një provë zjarri.
 34. Eshhtë mjeshtri me... baketë.
 37. Digjen po nuk u zbuluan.
 39. Igli të Lazio.
 41. Kush del... mbështet.
 42. Mund të jetë unik.
 46. Ngrihen për atentate.
 47. Janë fjetore në kazerna.
 48. Altini mesfushor.
- VERTIKAL**
1. Fillojnë matanë.
 2. Një Hans artist dadaist.
 3. Eshhtë mjet rrethanor lundrimi.
 5. Eshhtë ënjtje.
 6. Lumi i Elizit.
 7. Fillojnë mpirjen.
 8. Eshhtë e gjithë Hëna.
 10. Eshhtë qetësues për neurozat.
 11. Taylor aktore.
 12. Daniel i Robinson Crusoe.
 14. Kështu janë skenat që mallëngjëjnë.
 16. Eshhtë pjesë në skenë.
 17. Lëvizje Ekologjike Lokale.
 19. Përshkohej nga Leti.
 22. Eshhtë muzika më e... kollajtë.
 23. Grazia Cucinotta aktore.
 24. Veriu pa ekstreme.
 27. Janë tre në trickikël.
 30. Scola, regjisor italian.
 31. Kufizojnë një metër.
 34. Mbahet me inat.
 35. Mbyllin kurse.
 36. Ka një shpejtësi fantastike.
 38. Laik kur s'është ai.
 40. Një liqen i kripur.
 43. Një mund të jetë fetar.
 44. Eshhtë lloj papagalli.
 45. Në hyrje të sallës.
 46. Priten në skaje.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Janë lokale me kubiste.
9. Me të nxjerrin në tapë.
11. Polanski regjisor.
12. Qeni i famshëm i Odiseut.
15. Mbeten në fund.
16. Gabon në ekstreme.
18. Rreh në kufij.
19. Eshhtë vepër për një... vepër.
23. Janë udhëtime për një vend të shenjtë.
25. Dinë shumë gjuhë.
26. Një mendim.
27. Famëkeqi Capone.
28. Kush i kthen... të braktis.
29. Kisha pa zë.
30. I fjuari i kukullës Barbie.
32. Ritet pa re.
33. Një brinjë në skuadër.
35. Emri i Zola.

VERTIKAL


1. Barrymore aktore.
2. Tiriac që qe tenist.
3. Ekstreme në studim.
4. Eshhtë kleri me papën.
5. Ndezur në aparaturë.
6. Kaluar në krye.
7. Janë racë e pastër.
8. Një treg pa re.
10. Duhet fituar me djersë.
13. Një dritë për sake.
14. Lëvizin pasi mendohen shumë.
16. Janë sfera për bingo.
17. Eshhtë më pak se nxehtësi.
19. Gibson aktor.
20. Tregonin shkëlqer dikur.
21. Mund të jenë fetare të tilla.
22. Kush nuk ka... nuk i ecën.
23. Një sherr në shtyp.
24. Një lidhëz.
25. Mund të jenë cigaresh.
29. Mund të bëjë zoom.
31. Ndërmarrje Industriale Mirditë.
33. Pak konkrete.
34. Eshhtë i mirë me shokë shumë.
36. Artikull për shumë francezë.
38. Kanto kur nuk... ka.
39. Muzika me jam session.
44. Mbyllin një sherr.
45. Të fundit në sirtar.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

1			7	9		8	2	3	
			2				4		
3	7				5				
7	8					6		4	
			9			1		5	
			1	3				7	
5			7						
2		9	4	3		7			
						2		1	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	7	3	6	5	8	9	2	1	
6	8	1	7	9	2	3	5	4	
9	2	5	3	1	4	8	6	7	
8	9	4	1	2	7	6	3	5	
2	3	6	4	8	5	7	1	9	
5	1	7	9	3	6	2	4	8	
7	5	9	2	4	3	1	8	6	
1	4	2	8	6	9	5	7	3	
3	6	8	5	7	1	4	9	2	

Argëtim filozofik

-Jeni i ri vetëm një herë, por mund të jeni i papjekur përgjithmonë.

-Unë kurrë nuk mendoj, më lodh. Ose kur mendoj, nuk mendoj për asgjë.

-Të përsëritësh fjalët e dikuj, nuk do të thotë keni kuptuar dhe kuptimin e tyre.

-Lëreni heshitjen tuaj t'u flasë të gjithë atyre që nuk dëgjuan dhe nuk respektuan kurrë fjalët dhe veprat tuaja.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

9	1	2	4	16		17		18	50	P	6A	T	E	R	S	F	P	E	M	I	L	E		
11	3	2	5	4	18	6		5	18	3	2	R	A	K	T	R	E	B	E	L	E	T		
9	6	9		9	10			2	18		2	1	U	P	E	R	I	O	D	I	K	K	E	
8	1		9	11	1	3	1	3	2	5	2	3	D	I	N	A	S	T	I	A	D	E	T	
17		12	4	1	3	2	6	1	8	2	6	1	R	E	P	A	R	T	E	N	I	A		
7	4	10	3	2	6	12	3	1		14			G	E	R	E	K	K	I	R	K			
13	6	12	5	2	3	9	4	1		11	6	18	P	A	R	E	T	T	R	U	K	E	T	
14	6	2	4	9	1		4	10	1	1	12		I	U	I		G	O	A	L	K	R	A	
18	11		4	7		4		7	4	13	3		R	L		P	A	R	I	M	E	T	B	
2	6	7			3	1	10	6		6	2	2	O	L		T	I	T	A	N	E	I	L	A
6	15	2	3	9	3		4	1	6	12	4	6	G	E	U	N	I	T	E	T	V	I	T	
16	5	12	3	7	4	13	6		9	3	6	1	A	K	R	A	M	E	R	G	A	T	I	

-Kur dikush nuk të vlerëson, nuk përpiqesh t'i ndryshosh mendim...thjesht ik....

-Nëse një person ndryshon, është për dy arsye: ose sepse hapi sytë e tij, ose sepse mbylli zemrën e tij.

-Lum ai që nuk pret asgjë, sepse nuk do të zhgënjehet kurrë.

-Nëse puna ishte një gjë e mirë, atëherë të pasurit do ta mbanin të gjithë për veten e tyre

Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

T	E	R	A	P	I	A		K	B	E	V	A	
A	P	A	R	A	T	I		U	R	A	N	I	A
L	I	T	A	T	T	I		T	A	N	E	T	
I	K	T	A	T	R	I		V	A	L	E	T	
A	K	K	A	P	O	T		A	T	T	I		
M	A	R	A	T	O	N		E	O	D	T		
D	O	L	L	A	R	I		E	L	E			
K	S	I	A	K	A	D		E	M	I	A		
A	L	E	M	D	E	T		I	O	R	T		
M	A	E		L	E	T		I	E	N	E		
P	O	N	T	I	A	C		L	I	Q	E	N	I
I	S	H	T	A	T	I		A	D	E	T	E	T
A	T	L	E	T		P		A	T	E	K		
R	E	A	A	K		D		A	T	A	T	U	
M	O	T	K	A	P	I		T	A	L	E	R	
A	R	I	A	P	E	R		I	M	E	T	R	I
T	E	N	S	E	R	E		N	A	T	A	T	
I	M	P	E	L	I	K		A	N	I	R	A	
M	E	M	O	E	M	E		T	E	U	B		
E	A	L	E	T		E		N	T	E			
T	E	T	A	R		T		A	L	E	A	T	
M	A	R	T	A		N		A	K	A			
T	I	N	C	I	T	A		T	I	P	A	R	
R	E	T	H	I	T	A		A	R	T	E		

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

